




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

Nga Seanca e XX(njëzet) e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, mbajtur më 15.7.2011 me këtë:

REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të kuvendit dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e 24.06.2011 dhe seanca e jashtëzakonshme e 30.06.2011,

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

1. Shqyrtimi i propozimeve për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit,
2. Propozim vendimi për miratimin e plotësimit të Planit Rregullues Urban "Fidanishte",
3. Propozim vendimi për miratimin e dokumentit: "Komponent e PZHK-ës lidhur me vlerësimin e rrezeve dhe menaxhimin e fatkeqësive",
4. Projekt Rregullorja për ndarjen e Titujve të nderit, mirënjohjeve dhe shpërblimeve,
5. Projekt Rregullorja për kompensim të pagës për ish zyrtarët e lartë të komunës,
6. Marrëveshja investuese për ndërtimin e objektit afarist-banesor te Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim,
7. Marrëveshja investuese për ndërtimin e objektit afarist-banesor te Kombinati i Duhanit në Gjilan,
8. Autorizimi i KPF për monitorimin e implementimit të marrëveshjeve në PPP,
9. Bazat për bashkëpunim ndërmjet Komunës së Gjilanit dhe Bashkëpunimi Evropian për komunat më të fuqishme,
10. Propozim vendimi për kompensimin e Komisionit për çështje statutare,
11. Propozim vendimi për caktimin e lartësisë së kompensimit të Komisionit për çështje statutare dhe akte normative,
12. Autorizimi për Kryetarin e Komunës së Gjilanit për propozimet e ndërrimit të pronave komunale me ato shoqërore,
13. Informatë rreth provimit shtetërorë të maturës,
14. Informatë rreth punësimeve në SHCK,
15. Informatë rreth vizitave të punëtorëve të SHCK në Shqipëri

3. Të ndryshme,

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Seanca filloi punimet në ora 10.15min

Të pranishëm në punimet e Seancës së XX(njëzet) ishin:

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, z. Qemajl Mustafa

Drejtorët e drejtorive

Përfaqësuesit e MPL-së

Përfaqësuesit e OSB-së

Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut

Mediet

Seancën e XX (njëzet) e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili përshëndeti, anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e MPL-së, OJQ-të të cilat janë të pranishme në këtë Seancë si dhe mediet.

Në vijim të punës së Seancës kryesuesi propozoi që në rendin e ditës të inkorporohen edhe këto pika; Si pikë e parë është një kërkesë për Mulla Idrizin, që ne si KK. t' i rekomandojmë Presidentes që Mulla Idrizi të shpallet Hero i Popullit. Ne vetëm e bëjmë një rekomandim, kurse kompetente për ta shpallur Hero të Popullit Mulla Idrizin është Presidentja e Kosovës, znj Atifete Jahjaga.

Mandej i kemi edhe disa rekomandime:

-E kemi rekomandimin e Komitetit të Arsimit, për aprovimin e Rregullores për emërtimin e shkollave.

-Mandej propozimin-vendimin për shpalljen e interesit publik në fshatin Shurdhan

-Mandej e kemi propozim- vendimi për lejimin e ndërrimit të pronës për Gjimnaz, vendimin për të cilin është duke u punuar

Propozim- vendimin për lejim të pronës së AKP-së me "Don Boskon"

Është një kërkesë nga grupi parlamentar i PDK-së për t' i ngrit disa çështje të ndryshme.

Seanca është bukur ngarkuar me një numër bukur të madh të pikave, por për mos caktuar seancë tjetër para pushimeve, kjo seancë është më e ngarkuar, por besoj se me një punë serioze do t' ia dalim, kurse materialet i keni të gjitha, shifat e grupeve para se të fillojmë me rend të punës mund të paraqesin ndonjë problematikë.

Sokol Haziri- sa i përket rendit të punës, ne si grup e kemi dhënë pëlqimin tonë në KPF, por unë dua ta ngre një çështje këtu e cila ndoshta nën të ndryshme do të duhej për ta diskutuar, por unë dua që të sqarohemi qysh në fillim të seancës.

Ju siç e dini opozita ka votuar një vendim kundër në Asamblenë Komunale, por çfarë ka ndodh këto ditë? Dua të them se mënyra se si udhëheqësja e Hidromoravës ka vepruar me disa njerëz të cilët janë këtu anëtarë të Kuvendit është krejtësisht në kundërshtim me normat morale të sjelljes. Pa praninë e askujt me urdhër të drejtoreshës së kompanisë ekipet e kësaj kompanie kanë vizituar shtëpinë time e kanë hapur njehsorin, për pa qenë unë aty, por ka qenë vetëm vajza e mitur dhe unë fare nuk e di se çka kanë bërë! Vetëm kanë bërë fotografime, e cila do të ishte normale sikur të kishte persona madhor në shtëpi, mirëpo në pyetjen e vajzës sime kush jeni dhe çka po bënë? Përgjigja ka qenë na vije keq ne nuk kemi dashur të vijmë, por na ka urdhëruar drejtoresha! Unë nuk e di se çka është ky veprim kështu!? Nuk e di se çka është kërkuar të bëhet me këtë veprim? Por sidoqoftë unë po iu them se nga ky moment, kjo është një situatë e cila nuk përkon me kohën në të cilën jetojmë. Ju e dini se regjimet totalitare kanë bërë veprime të tjera dhe strukturat e sigurimeve të ish

sistemeve kanë pasur mundësi të veprojnë kështu, por në ditët e sotme të veprohet kështu, kjo është krejtësisht e papranueshme dhe cenon drejtpërsëdrejti edhe integritetin e njerëzve dhe mund të them shumë qartë se këta njerëz mund të jenë oponent të pushtetit dhe të partisë në pushtet dhe dëshiroj qartë të deklaroheni prej diferencimit të këtyre formave të veprimit ose për mbështetje të këtyre gjërave.

Unë nuk kam asnjë dilemë që këtu është qëllim i caktuar, por dëshiroj ta personalizoj këtë çështje i kujt është? Për ndryshe pa prezencën time dhe pa prezencën e një personi madhor, unë veprimet e tilla nuk i pranoj dhe do të inicioj edhe çështje të tjera.

Por për hir të veprimeve të përbashkëta të cilat i kemi ndërmarrë, kisha pasur dëshirë që të deklaroheni edhe ju?

Arben Mehmeti- unë para se të fillojmë me punë, e mbështesë fuqishëm propozimin shefit të grupit parlamentar të AAK-së, sepse ky është një lloj shantazhi për anëtarët e KK-së me të cilat forma duan që t' i bien para akteve të cilat janë në shërbim të atyre kompanive.

Mirëpo ne nuk duhet lejuar kështu lloj shantazhe t' i bëhen anëtarëve të Kuvendit, por e kam parasysh edhe faktin se pikërisht këto shantazhe burimin e kanë të kryetari i Komunës, sepse kur kemi njoftuar se ka ndodhur një kërcënim në të kaluarën, në vend se t' i epet vërejtja zyrtarit përgjegjës, kam marrë unë një vërejtje nga kryetari i Komunës e që është veprim jashtë çdo logjike.

Këto veprime duhet diskutuar dhe njëherë e përgjithmonë, duhet të ndalen këto kërcënime ndaj zyrtarëve komunal dhe nuk ka askush të drejtë të vijë me ekipe speciale për të na vizituar neve, sepse këto nuk kanë ndodhur as në kohën e Serbisë, kurse në kohën kur kemi punuar për të ardh në këtë gjendje është shumë e papranueshme. Kështu që unë e mbështesë dhe kërkoj që të jetë pikë e veçantë e rendit të ditës.

Mandej unë propozoj që pika 12,13,14, të jetë pika e dytë e tretë dhe e katër, pas propozimit të parë, sepse këto pika janë kërkesa të opozitës në një mënyrë, prandaj për të mos humb interesimi për shkak të lodhjes, ne kërkojmë t' i përfundojmë së pari këto pika, pastaj të vazhdojmë me të tjerat.

Kërkesa pra është të bëhet zhvendosja e pikave nga fundi në fillim.

Izmi Zeka- pikat nuk është mirë të zhvendosen pasi që kanë qenë në rend të punës dhe në KPF, këto kanë qenë shtesë dhe këto i kemi mundësuar për shkak të transparencës, por edhe ka qenë kohë e shkurtër. Ne dhe po ta bëjmë ndonjë lëvizje, kjo nuk do të ketë ndonjë efekt tjetër

Arben Mehmeti- unë po e kundërshtoj atë që e thotë kryesuesi se gjëja ka qenë kohë e shkurtër dhe nuk kemi pasur mundësi të merremi me këtë çështje shumë, por po iu përkujtoj se këto pika janë kërkuar së paku para dy muajve e të cilat ka qenë desh të jenë në fillim.

Izmi Zeka- kërkon nga sekretaria për ta vërtetuar praninë e anëtarëve të Kuvendit në Seancë?

U konstatua nga sekretari se në sallë janë të pranishëm 39 anëtarë, kurse mungojnë: Sabedin Kadriu dhe Abdyl Aliu

Izmi Zeka- çështjen e Hidromoravës do ta debatojmë në fund, kurse nga anëtarët e Kuvendit kërkoj që të deklaroheni se a jeni për këtë rend të punës ashtu si është propozuar me plotësime ?

Aprovohet rendi punës me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët nuk u deklaruan

1. Rekomandim për shpallje Hero të Popullit, Mulla Idriz Gjilanin
Izmi Zeka- materialin e keni për këtë rekomandim dhe e dini se Mulla Idrizi meriton respekt të veçantë jo vetëm për Gjilanin, por për tërë institucionet shtetërore të Kosovës.
Ne pas 60 viteve sado pak po i dalim hakësh dhe po mundohemi që t' i bëjmë nderin më të madh të cilin e ka merituar, por edhe një respekt për neve që patëm një njeri të tillë.
Ju e keni materialin, ne me shefat e grupeve parlamentare jemi marrë vesh dhe nuk do të ndalem shumë për ta elaboruar figurën e Mulla Idrizit, prandaj unë kërkoj prej juve që ta rekomandojmë si vendim- propozim i KK-së që M. Idrizi të laureohet me Medalje të Lartë të Republikës së Kosovës për merita në ruajtjen e substancës etnike shqiptare të Kosovës e të viseve shqiptare të Kosovës e të viseve shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia Versajiste dhe Avnojiste
Ne këtë e bëjmë si rekomandim, kurse shpalljen e bën presidentja e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga.
Kush është që të hartohet ky vendim- propozim ?

Aprovohet- propozim vendimi me vota anonime të anëtarëve të Kuvendit që: Mulla. Idrizi të laureohet me Medalje të Lartë të Republikës së Kosovës për merita në ruajtjen e substancës etnike shqiptare të Kosovës e të viseve shqiptare të Kosovës e të viseve shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia Versajiste dhe Avnojiste

Procesverbali

Aprovohet procesverbal i datës 24.6.2001 dhe i seancës së jashtëzakonshme i datës 30.6.2011 pa vërejtje

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

1. Shqyrtimi i propozimeve për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit,

Izmi Zeka- kjo pikë është diskutuar gjatë, prandaj sot do ta marrin fjalën vetëm shefat e grupeve parlamentare dhe në fund ta aprovojmë me koncenues.

Ejup Haziri- nuk dua ta zgjas më tepër ne i mbështesim plotësimet dhe ndryshimet e Statutit.

Arben Mehmeti- edhe grupi parlamentar i LDK-së e mbështet statutin në të gjitha pjesët dhe nenet me përjashtim të nenit ku parashihet formimi i Drejtorisë për Ekonomi. Do të thotë nuk e mbështesim rritjen e numrit të drejtorive siç është kjo që e përmenda.

Sokol Haziri – me gjithë rezervat e mëdha që kemi dhe vullnetin politikë për të mbështetur diçka, çka nuk është në interes të Komunës, megjithatë ne po përcaktohem në kuptim të zbatimit të ligjit për decentralizmin si vendim i nivelit qendror, ne nuk jemi në dakord që të përfshihet në ndryshime statutare edhe çështja e shtimit të një drejtorie, sepse e konsiderojmë të tepërt.

Jakup Bajrami- edhe ne si grup i LDD-së mendojmë se ajo drejtori është e tepërt dhe nuk mbështesim këtë drejtori.

Arben Maliqi- edhe ne si grup e mbështesim, por kemi rezervë, sepse më takon si qytetar i Komunës së Gjilanit që nenin 8 pika 10.2, kur është territori i Komunës së Gjilanit, konkretisht e kam fjalën për fshatin Kosaçë i cili nuk është as me Gjilan, por nuk është as me Novo Berd.

Ibrahim Neziri- ne i japim mbështetje plotësimi dhe ndryshimit të statutit

Izmi Zeka- ne kemi debatuar gjatë për këtë statut dhe nuk ka nevojë tash të politizohet, sepse kjo është çështje obligative, sepse ligji vlen për territorin e Kosovës për të gjitha komunat njëjtë. Megjithatë ju e dini qëndrimin parimor tonin (të PDK-së) dhe e dini se ne kemi qenë kundër decentralizimit në baza etnike. Mirëpo kjo është vendosur në parlament, kurse ne kemi vetëm obligim për ta implemetuar dhe nuk ka nevojë t'ia hedhim fajin askujt. Ne dimë si është gjendja, por besoj shumë se kjo do të riparohej, sepse kështu nuk funksionon, por po e përsëris kjo nuk është dëshirë e jonë, por e kemi obligim ligjor.

Sa i përket çështjes së një drejtorie, duhet ditur se të mirat dhe të këqijat i merr për përgjegjësi ai që e udhëheq dhe nëse ne gabojmë për drejtorinë të cilën e kemi propozuar ne e marrim përgjegjësinë, mirëpo është mirë të votohet që projektet e Komunës të shkojnë deri në fund ashtu si janë planifikuar dhe mos të jemi pengesë e KK-së, për ta stopuar këtë proces i cili është procesi më i ndjeshëm. PP dhe zhvillimi ekonomik në Kosovë është punë e ndjeshme, prandaj kërkoj që ta votojmë Statutin e Komunës me këto ndryshime të cilat janë propozuar.

Përgjegjësia për drejtori të na mbetet neve dhe mos të brengoseni për të, ajo është përgjegjësi e jona.

Qemajl Mustafa- dje në Komitetin për Politikë dhe Financa ka qenë një takim ndër informues me një përfaqësues të USAID-it i cili punon në komponentin e zhvillimit ekonomik dhe jemi munduar vetëm ta pasurojmë opinionin, pse do të duhej kjo njësi të lidhet me këtë drejtori?

Kjo është imperativ për ngritjen e bazës ekonomike të Komunës dhe të Kosovës në përgjithësi dhe nga ky donator dhe si mbështetës i fuqishëm i Qeverisë Amerikane është thënë që do të duhej dhe do të ishte mirë që të kemi një adresë të saktë. Duhet ta kemi një njeri përgjegjës sa i përket përgjegjësisë dhe adresimit të çështjeve, kështu është thënë.

Unë mendoj se ne e kemi bërë një diskutim të rrafshët dje me shumicën e subjekteve politike në Komitetin për Politikë dhe Financa. Unë mendoj se jemi kuptuar, sepse e kemi bërë një bisedë shumë të rrafshët dhe kemi ardh në një konstatim që do të duhej liru me atë kushtin e lirimit prej një ankthi nga opozita, se kur një iniciativë e ndërmerr pushteti i pari akt që është legjitim për mua dhe i bie ndërmend dikujt, mos ndoshta kjo po bëhet për interesa për ata që janë në pushtet ose edhe më ngushtë për interesa të një grupi ose individi.

Për mua është ai hezitim dhe ajo dilemë e ngritur për mua është legjitime, përndryshe do t' i kishim thënë ndryshe atij grupi që nuk është në pushtet, por i thonë opozitë.

Ta themi përfundimisht se nuk po projektohet dhe themelohet asnjë drejtori për individin e parapërcaktuar, për individin e njohur ose për ndonjë stafi brenda asaj drejtorie.

Në këtë aspekt qysh sot po e them se nuk kemi mundësi të pranojmë njerëz të rinj, kemi mundësi për të bërë lëvizje të brendshme dhe aty mund të jenë dy-tre zyrtarë dhe kemi mundësi gjatë vitit për ta blerë ndonjë shërbim për t' i ngritë ato kapacitete dhe për të kryer punë për Komunë.

Unë iu lus që të vazhdojmë me punë të mirë si e kemi bërë deri më tash duke filluar që nga fillimi i vitit 2007 dhe në këto vite dhe tepër rrallë mund të numërohen në gishtat e një dore në momentet kur opozita nuk ka desh për ndonjë arsye për ta votuar ndonjë çështje.

Do të thotë kemi punuar me koncenzues, sepse e kemi hapur debatin e kemi shterë të gjitha mundësitë deri në koncenzues.

Izmi Zeka- nga ana e kryesuesit të Kuvendit kërkohet 5 minuta për të biseduar edhe njëherë me shefat e grupeve parlamentare?

Pas pauzës pre disa minutave, kryesuesi i Kuvendit, z. Zeka theksoi se në bashkëpunim me shefat e grupeve parlamentare u pajtuam se duhet bërë edhe një konsultim të përbashkëte deri në javën e ardhme. Në javën e ardhshme do ta kemi vetëm këtë çështje dhe në javën e ardhshme vendosim.

Propozoj që kjo pikë e rendit të punës për këtë seancë të shtyhet dhe të kalojmë në pikat tjera të rendit të punës.

2 Propozim vendimi për miratimin e plotësimit të Planit Rregullues Urban “Fidanishte”,

Izmi Zeka – z. Kryesuesi theksoi se edhe kjo pikë është debatuar në KPF dhe është rekomanduar në Kuvend, por një arsyetim të shkurtër kërkoj që të na japin drejtoresha e DUMM.

Bahrie Mamuti- lidhur me këtë pikë arsyetimin e dha drejtoresh e DUMM, znj Bahrie Mamuti të cilin arsyetim anëtarët e Kuvendit e kanë pasur dhe në materialin e seancës.

Izmi Zeka- e falënderoj drejtoreshën për elaborimin të cilin e bërë, por tash besoj se z. Arbeni do ta komentoj ligjin për ndryshimet të cilat po i bëjmë, sepse nuk ka të drejtë të bëhet ky ndërrim për 5 vjet, prandaj e ka falën Abren Mehmeti.

Arben Mehmeti- faleminderit z. Kryesuese, sepse pjesën më të madhe e thatë ju, por kjo edhe evidentohet në procesverbal dhe më vjen shumë keq që këtu nuk është prezent ai zyrtari i MPL-së për të cilin e kam qëndrimin personal që nuk është mirë të vijë fare, sepse prezenca e tij këtu nuk është fare profitabile në këtë Kuvend. Ata e kanë për obligim të raportojnë në këtë Kuvend për problemet dhe thyerje të ndryshme të ligjeve, por si duket nuk e kanë atë mision, por vijnë këtu sa për t’u evidentuar se ka qenë prezent e pastaj, shkojnë.

Më vjen keq që nuk gjendet këtu, sepse kam pasur për të thënë për te diçka më tepër dhe për ministrinë përkatëse.

Ndërsa për drejtorinë dhe drejtoreshën, unë e rekomandoj që të jetë shumë e kujdesshme, sepse për një kohë shumë të shkurtër si drejtoreshë ka pasur shumë shkelje ligjore dhe jam shumë i sigurt që organet kompetente do të merren me rastet e DUMM.

Këtë po them se kemi shkelje ligjore të Ligjit mbi planifikimin hapësinor, të cilat shkelje janë konstatuar në seancën e kaluar të KPF-së. Vërejtja e ime në këtë komitete ka qenë se vendimi nuk ka qenë i bazuar juridikisht i kësaj drejtorie, kurse tash na vjen një vendim tjetër, sepse janë ndryshuar disa nene këtu, por prapë nuk është ndryshuar esenca e një neni në ligjin përkatës e që është afati 5 vjeçar.

Më vjen keq që kryesuesi në një mënyrë po i bëhet bashkëpunëtor drejtorit i cili bën shkelje ligjore. Unë nuk jam për atë që Kuvendi të aprovojë blanko vendime të paligjshme të drejtorisë përkatëse.

Ju e dini në seancën e kaluar dhe në seancat tjera të kaluara na ka arrit një vendim nga Urbanizmi dhe ku thuhet hartuesi i harmonizimit dhe plotësimit të këtij plani është “Favoringu” me seli në Prishtinë, kurse ai kurrë nuk e kishte pasur selinë në Prishtinë, por e kishte pasur në Prizren, prej kohës që është themeluar!

Dikush mund të thotë gabim teknik, por ajo tash është përmirësuar dhe nëse dikush thotë se vetëm po flasim, e ka shumë gabim, sepse këto po shihen!

Edhe njëherë po e potencoj që Kuvendi nuk duhet të merret me këso vendime të paligjshme dhe LDK e ka adresuar një shkresë zyrtare në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si organ kompetent për vlerësim të ligjshmërisë të akteve të këtij Kuvendi. Ne presim që kjo ministri t' i shqyrtojë vendimet dhe të na kthejë një përgjigje zyrtare. Mirëpo në momentin që ne nuk jemi të kënaqur ka struktura tjera ligjore të cilat do të merren me ligjshmëri të vendimeve të këtij Kuvendi.

Në fund ne si grup parlamentar i LDK-së nuk jemi pajtuar as në të kaluarën për shkelje ligjore, nuk jemi pajtuar as nuk do të pajtohemi me vërejtje të cila i kemi thënë në komitete përmes përfaqësuesve tanë, që në këtë çështje nuk është përfshirë Këshilli i Ekspertëve e që është obligim ligjor për konsultim me këto plane rregullative dhe veprime të tjera të paligjshme të cilat na kanë sjell para një akti sa ne vetëm për ta legjitimuar paligjshmërinë e këtyre vendimeve. Unë kam rekomandim që drejtoria përkatëse të na thotë që po i ndalim këto procedura të paligjshme, sepse deri më tash kemi vepruar kundër ligjit!

Ramiz Ramadani- pasi që kryesuesi është më kompetent këtu për zbatim të ligjit po ia lexoj nenin 15.2 të Ligjit për planifikim hapësinor i cili thotë: “secila komunë do t’ i shqyrtojë dhe nëse është nevojë ndryshojë planet rregulluese urbane çdo pesë vjet”. Unë nuk e di si të kuptohet ndryshe ky formulim i këtij ligji?

Neni 20 thotë: “ nëse ndodhin ndryshime “ logjika e kupton pas pesë vjetëve, kur Komuna e ka atë të drejtë thotë : “ është e domosdoshme që procedura të përfillet si në miratim fillestar.” Drejtoresha në një takim të komitetit thotë se : “ për shkak të pakënaqësive që kemi pasur me kompaninë “Favor Ing”, Komuna ka marrë vendim që hap planin rregullativ “Fidanishtja” për ta plotësuar dhe për ta ndëshkuar këtë kompani dhe mos të ketë më të drejtë të marrë plane në Komunë të Gjilanit.

Mirëpo ajo që ndodh tash i ndodh pikërisht kësaj kompanie, sepse i epet plotësimi, por më keq për dallim prej herës së parë i epet pa procedurë dhe në mënyrë të papranueshme!

Nuk ka pasur tender nga Zyra e prokurimit, mandej është thënë se ka pasur takime me komunitetin, por ne kemi kërkuar dhe asnjëherë nuk i kemi pasur procesverbalet për të parë se cili ka qenë opinioni i qytetarëve? Është anashkaluar Këshilli i Ekspertëve i cili është i paraparë me ligj dhe kemi kërkuar dhe asnjëherë nuk e kemi pasur koston financiare, të cilën së paku sot duhet ta kemi se sa ka kushtuar ky projekt?

Sokol Haziri- unë vetëm një pyetje e kam për drejtoreshën e DUMM. Ne jemi marrë vesh parimisht që ligji duhet zbatuar me përpikëri, sepse është obligim ligjor. Çka po ndodhin këto ndryshime kaq të shpeshta a ka mundësi për të na i sqaruar? Cili është motivi që po i bëjmë këto ndryshime?

Izmi Zeka- në fillim e thash se duhet të jemi në proces të çdo procedure, sepse ne edhe kur bëjmë ndonjë ndryshim, qytetarët nuk janë të njoftuar, sepse njerëzit nuk vijnë, ne kot e thërrasim debatin publik! Mirëpo pas një kohe dalin kërkesa të tjera dhe nga disa qytetarë thuhet unë nuk kam qenë! Tash po e them shumë qartë ne jemi për të punuar për qytetarët dhe për interesin e tyre dhe interesin e bizneseve në Komunë të Gjilanit.

Ne nuk do ta mbyllim rrugën, është bërë një projekt për “Fidanishten”, por ka pasur sugjerime të tjera, ka pasur sugjerime për lëvizje të cilat për një pjesë ndikojnë edhe në zhvillimin ekonomik. Ne dimë që është 5 vjet, pastaj mund të rishikohet, por Kuvendi si institucion komunal e merr për sipër përgjegjësinë, merr përgjegjësi, por për interes të qytetarëve dhe jo

për interesa të ngushta individuale. Ne kemi propozuar ndryshime të vogla dhe nuk janë ndryshime thelbësore. Unë jam i mendimit se koha po ec dhe përsëri do të ketë kërkesa për ndryshime. Ju e dini si Qarku është aprovuar dhe ndoshta nuk iu kemi përmbajtur kërkesave, sepse ka pasur kërkesa për ndryshime. Unë jam ithtarë i asaj që koha po kalon, kërkesat po ndryshojnë, kurse Komuna është për këto punë.

Florinë Zymberi- e përshëndes drejtoreshën për këtë punë e cila është bërë, por unë vetëm desha ta njoftoj Kuvendin, se kjo çështje është debatuar edhe në Komitetin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit i cili propozim ka kaluar pozitivisht dhe ky plotësim nuk bie në kundërshtim me Planin zhvillimor urban dhe Planin rregullativ urban. Këtu ka ndodhur ndërrimi i hapësirave nga biznesore në banesore afariste! Kemi raste kur kërkohet shndërrimi i sipërfaqeve nga biznesore në atë afariste dhe sigurisht që kjo është më e komplikuar se e kundërta. Arkitektura ruhet, sipërfaqja shfrytëzuese ruhet, infrastruktura ruhet, zbuten ndërtimet pa leje dhe ruhet toka. Interesi i jonë është që sa më tepër t' i orientojmë popullatën të shfrytëzojnë banesa jo shtëpi përfitohen taksa dhe vende pune etj.

Ne jemi këtu për qytetarët dhe i tërë angazhimi bëhet për qytetarë dhe në fund mendoj se këtë propozim- vendim duhet aprovuar. Biznesit dhe afarizmit duhet dhënë një tretman më të avancuar dhe unë iu ftoj zotërinj kuvendar që ta votoni këtë propozim-vendim.

Bahrie Mahmuti- unë do të them se sa i përket kritikës së Arbenit, më vjen keq që kanë ndodhur ato gabime teknike të formulimi të vendimit, kurse në aspektin se sa ka të drejtë të ndryshohet plani brenda 5 viteve, konsideroj se me ndryshimet të cilat kanë ndodhur pas procesit të aprovimit, duhet të bëhen ndryshime. Me vet faktin se neve një pjesë e territorit me proces të decentralizimit na është cinguar, prandaj paraqitet nevoja që të bëhen ndryshime dhe konsideroj se kjo duhet të ndodh shumë shpejt. Ne kemi pasur takime me ministrinë dhe ato duhet të trajtohen si plane të veçanta dhe nëse ne tash thirrmi dhe themi 5 vjet nuk kemi të drejtë me vet zhvillimet që po ndodhin ne jemi të obliguar për t' i bërë këto ndryshime.

Në ato pjesë shumë shpejtë do të bëjmë ndryshime dhe ato do të jenë si plane të veçanta.

Duke i parë zhvillimet që po ndodhin, atëherë edhe këto zona duhet të plotësohen me ndryshime.

Qemajl Mustafa – Ahtisari prej vendit prej të cilit vjen 100% e respekton këtë do të thotë 5 vjet, nuk ka ndryshime, por në Kosovë këtë nuk e ka pasur parasysh. Ai ka ardhur për ta rregulluar një proces dhe nuk është brengos fare, kur Gjilani e ka aprovuar planin zhvillimor dhe komunal. Kjo është e vërtetë që po thotë drejtoresha, por kjo është një rast i veçantë. Puna e decentralizimit është rast i veçantë, lëvizja e kufijve është rast tepër i veçantë dhe që mund të ndodh shumë rrallë.

Mirëpo e vërteta qëndron këtu; se ligjet e veçanta për vendet në tranzicion si jemi ne, për vendet e varfra dhe shtete të reja nuk bëhen dhe askund nuk thuhet, që një pako e ligjeve që po votojmë këtyre viteve, është pako e ligjeve për një vend të brishtë, për një demokraci të brishtë me kapacitetet e cingura ende dhe me një dinamikë të madhe të zhvillimeve në tranzicion. Këta që kanë qenë në Kuvend të Kosovës e dinë që ligjet me shumicë janë ligje që merren prej modeleve nga Bashkimi Evropian, por të cilat adaptohen teknikisht në rrethana të Kosovës. E vërteta është se 5 vjet është shumë kohë e gjatë për këto zhvillime dinamike dhe me këtë pamundësi të shpronësimit të pronave të privatistëve në hapësirën publike për të mos pasur ndryshime.

Të gjithë jemi dëshmitar të Qarkut ku kemi tash më ndërhyrje legjitime të pronarëve të tokave, sepse ata kanë pritur një vit, kanë prit edhe dy dhe është kaluar ai pesë vitëshi të Qarku dhe askush nuk pret më.

Ne kemi planifikuar gjelbërim, rrugë shkollë, në pronën private, por ata njerëz i kanë nevojat e veta për ta ndërtuar një shtëpi ose hapur një biznes dhe ka filluar dhunshëm në ato punë.

Është shumë mirë që jemi kthyer te “Fidanishtja” për pa ndodhur ende asnjë zhvillim atje, sepse ajo është votuar para një kohe shumë të shkurtër. Ne e kemi rihapur, sepse i kemi parë disa të meta, të cilat janë të gjithë neve të nderuar këshilltarë dhe drejtorë.

Ato projekte kanë qenë të hapura para publikut, debatet kanë qenë shumë të gjata dhe e vërteta është që ka kaluar nëpër Komitet të Urbanizmit dhe ka kaluar nëpër Këshillin e ekspertëve edhe atë disa herë. Ka kaluar në KPF, ka ardhur në këtë Kuvend këtu dhe ato të meta nuk i kemi vërejtur. Palët nuk kanë ardhur në debat dhe janë dy raste të cilat kanë qenë njëherë ose nuk kanë qenë dhe në fund është parë se është bërë një lloj joracionalizmi, njëfarë sakatosje e pronave të tyre të cilat janë të konsiderueshme.

Ne këtë e kemi hapur dhe kur e kemi hapur, këtë e kemi bërë me miratim të Kuvendit, për ta korrigjuar dhe për ta bërë më mirë për qytetarët e asaj ane. Nuk do të thotë se krejt ia kemi qëlluar, përsëri dikush do të ankohet, por ky le të merret si rast i veçantë të përmbyllet “Fidanishtja” dhe ne nuk do ta hapim çdo ditë natyrisht. Do të ketë ankesa, kërkesa individuale të cilat e tejkalojnë këtë ligj, gjegjësisht këtë projekt, por ne nuk do të kthehemi çdo ditë në këtë projekt. Mirëpo a do të jetë ajo ngurtë 5 vjet, unë mendoj se jo edhe atë te të gjitha planet. Unë iu lus që me koncenzues, si kemi votuar më parë ta votojmë edhe tash.

Arben Maliqi- rreth kësaj pike, unë e kam një opinion timin dhe të grupit, sepse dihet mirëfilli se ne këtë plan rregullues e kemi miratuar në Kuvend, por ndodhi që prapë ta debatohet për plotësim apo rimiratim sido që t’i themi. Mirëpo unë e kam përmend edhe më herët dhe kam thënë është mirë që të bëhet trasimi i rrugëve. Sikur të ishte bërë trasimi i rrugëve, atëherë nuk do të kishte ndodhur ky problem! Ne tash i kemi 7 ankesa, por do të kemi përsëri dhe pas disa ditëve, do të ndodhin edhe 7 të tjera. Mirëpo për të mos ardh deri te këto mosmarrëveshje është mirë që të bëhet trasimi i rrugëve. Të definohen rrugët dhe atëherë çdo gjë është e përfunduar. Kështu që është mirë të mendohemi, sepse të mira janë plotësimet, por duhet pasur kujdes mos të ndodhin probleme të tjera.

Ramiz Ramadani- unë personalisht e kam shumë të freskët kohën kur e kemi aprovuar Planin rregullativ. Prezantimi kur ka ndodh për këtë plan secila i ka thënë fjalët më të mira, bile në mënyrë të veçantë kryetari. Ajo që ne sot po e kundërshtojmë është se ne nuk jemi aq të ngurtë se asgjë nuk guxon të preket në këtë pikë, por duhet evituar konfliktin e interesit. Nëse ne për hatër të secilit fillojmë për të ndërhyrë në plane të tilla, unë mendoj se kjo nuk përfundon kurrë! Për herë do të del dikush kujdestar të cilit nuk do t’i del mirë. E ka kohën e ka mundësinë kur duhet të ndërhyhet dhe duhet të jemi serioz. Kur ta aprovojme një vendim ai e ka një kohë të caktuar dhe plotësimet ndodhin në kohë të caktuar.

Izmi Zeka- kjo çështje e “Fidanishtes”, sot po debatohet dhe më nuk i vjen rendi të debatohet në Kuvend, sepse janë disa rregulla. Mirëpo kanë qenë disa kërkesa të cilat kanë qenë të arsyeshme. Unë kërkoj të votohet dhe ju lus të deklaroheni se kush është për?

Aprovohet pika 2 e rendit të punës: Propozim vendimi për miratimin e plotësimit të Planit Rregullues Urban “Fidanishte”, me 18 vota për të anëtarëve të Kuvendit, kurse 9 ishin kundër, të tjerët abstenuan.

- 3 Propozim vendimi për miratimin e dokumentit: "Komponenta e PZHK-ës lidhur me vlerësimin e rreziqeve dhe menaxhimin e fatkeqësive",

Bahrie Mahmuti- znj. Drejtoreshë e arsyetoi këtë pikë të rendit të punës para anëtarëve të Kuvendit të cilin arsyetim anëtarët e Kuvendit e posedojnë në materialin për seancë.

Ramiz Ramadani- fillimisht po e bëj me dije që do ta pranojmë këtë plotësim, por do t' i jap disa vërejtje të cilat konsideroj se janë të arsyeshme.

E para, Plani zhvillimor komunal, është aprovuar më 2008 dhe besoj se këto dukuri si janë tërmetet, vërshimet, erozioni dhe zjarri nuk janë dukuri të cilat kanë ndodhur pas vitit 2008, por janë shumë më parë të njohura. Prandaj atëherë ka qenë desh të përfshihen jo tash, nëse tash është desh të plotësohet Plani zhvillimor komunal mendoj që është desh të plotësohet me masa teknike. Ka qenë desh të jetë shumë më i detalizuar, sepse reduktimi i këtyre rreziqeve mendoj se më shumë është aspekt teknik. Si shembull po e them se nëse përmbytjet ndodhin për shkak të kapacitetit të ngushtë të shtratit të lumenjve dhe këtu ka qenë desh të theksohet se cilët lumenj paraqesin rrezik? Kur mendohet të merren masat dhe cilat janë ato masa?

Një vendim që këtu ka qenë desh të merret mendoj se duhet të jetë ai rigoroziteti maksimal i objekteve të ndërtimit, sepse ne dimë se kemi shumë ndërtime pa leje.

Në material mungon se cilat janë ato 9% të zonave të erozionit, cilat janë masat të cilat do të realizohen. Mendoj se kjo i mungon këtij dokumenti, por megjithatë është një material i mirë ne do ta plotësojmë. Një gabim që duhet përmirësuar është se në material thuhet se Gjilani ka klimë kontinentale, prandaj duhet përmirësuar në e mesme kontinentale, sepse dallon është një dokument zyrtar.

Izmi Zeka- kryesuesi kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të aprovohet kjo pikë e rendit të punës me vërejtjet që i bëri Ramiz Ramdani?

Aprovohet pika 3 e rendit të punës: Propozim vendimi për miratimin e dokumentit: "Komponenta e PZHK-ës lidhur me vlerësimin e rreziqeve dhe menaxhimin e fatkeqësive", me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

4. Projekt Rregullorja për ndarjen e Titujve të Nderit, Mirënjohjeve dhe Shpërblimeve

Izmi Zeka- ne kemi autorizuar një komision për ta hartuar një projekt rregullore të tillë, për të cilin propozim, fjalën do ta ketë shefi i Zyrës ligjore z. H. Matshi.

Hevzi Matoshi- i nderuari, Kryetar i Komunës, Kryesues i Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë dhe Financa dhe anëtarë të KK-së.

Në Pajtim me LVL-në neni 40 paragrafi 2 pika h) dhe neni 5 paragrafi 3 të Statutit aktual në fuqi,

Dhe duke u bazuar në autorizimet që ka pasur Komisioni për çështje statutare dhe akte tjera, ka proceduar me punë në hartimin e projekt – rregullores për Ndarjen e Titujve të Nderit, Mirënjohjeve dhe Shpërblimeve.

Me këtë projekt e rregullore rregullohet forma, përmbajtja dhe procedura e ndarjes së titujve të nderit, mirënjohjeve dhe shpërblimeve. Sipas saj janë të përcaktuar titujt e nderit si “Qytetar Nderi”, “Nderi i Qytetit”, Medalja “Sportist i dalluar i Vitit” dhe dhënia e mirënjohjeve dhe shpërblimeve.

Neni 3 i projekt rregullore përcakton rregullën se kujt mund ti jepet apo ndahet titulli qytetarë nderi dhe përbërjen e titullit që është një çelës që simbolizon çelësin e portës së komunës i përcjell me një certifikatë solemne.

Neni 4 i projekt rregullore përcakton rregullën se kujt mund t’i jepet apo ndahet titulli “Nderi i Qytetit” dhe i njëjti përbëhet nga një pllakat dhe fletë-mirënjohje.

Neni 5 i projekt rregullore përcakton rregullën se kujt mund t’i jepet apo ndahet titulli “Sportisti i Vitit” dhe i njëjti përbëhet nga një medalje e shoqëruar me një fletë –përcjellje.

Neni 3 i projekt – rregullore përcakton rregullën që sanksionon organet kompetente të cilat mund të iniciojnë ndarjen e titujve të nderit, ku sipas kësaj këtë mund ta bëjë Kryetari i Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa, së paku 1/3 e anëtarëve të KK-së, cilido institucion tjetër i komunës, ose së paku së paku 1/3 e anëtarëve të KK-së, cili do institucion tjetër i komunës, ose së paku 2000 qytetarë të përhershëm të komunës së Gjilanit.

Përpos ndarjes së titujve të nderit, komuna mund të jep apo ndaj mirënjohje dhe shpërblime. Mirënjohjet sipas kësaj rregulloreje mund të shoqërohen edhe me shpërblim financiar në pajtim me statutin e komunës në rast se KK-ja nuk vendos ndryshe.

Pas sugjerimeve, propozimeve eventuale që mund të ketë nga anëtarët e KPF-së i rekomandoi komitetit që projektin – rregullore ta rekomandoi për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës.

Shfrytëzojë rastin që publikisht t’i falënderojë të gjithë anëtarët e Komisionit për çështje statutare dhe akte tjera normative për kontributin e tyre që kanë dhënë në hartimin e këtij akti.

Ju faleminderit!

Sokol Haziri- në parim si grup i këshilltarëve e mbështesim këtë rregullore, por kam bindjen se e kam parë këtë rregullore më herët me një komunë tjetër Shtime apo Ferizaj, apo diku tjetër? Prandaj i kërkoj këtij grupi që të jenë më kreativë.

Qemajl Mustafa- edhe kështu si është, është mirë të miratohet me mundësinë e ndryshimit në të ardhmen, por shumëçka nuk është përfshirë. E vërteta është se në mënyrë të veçantë është sanksionuar sportisti i vitit, por nuk janë vetëm sportistët ata të cilët duhet të theksohen dhe shpërblehen në fund të vitit. Janë edhe talentet dhe punëtorët e mirë të kësaj Komune, janë njerëzit të cilët duhet shpërblyer për vepër karriere, mandej janë talentet e veçantë të cilët theksohen shumë shpesh në këtë Komunë.

Mirëpo ka edhe grupe të tjera të shoqërisë si piktorë, sportistë, rinia dhe të tjerët.

Unë mendoj se Rregullorja si edhe disa të tjera po projektohen disi përciptë, jashtëzakonisht thjeshtë dhe të pa përkushtim dhe kjo nuk është e mirë.

Jam për që edhe kështu të kalojë, vetëm bëjmë shumë gabim dhe lëshim nëse në procesverbal nuk thuhet që: “ kjo rregullore ka shumë të meta, është e mangët dhe është gjysmë rregullore”. Pasi që kjo nuk është e ngutshme unë kisha thënë që kjo të hyjë edhe njëherë në përpunim dhe të vijë diku në shtator në aprovim, ose në parim mund ta votojmë edhe sot, por me këto ndryshime të cilat dëgjohen sot prej anëtarëve të Kuvendit.

Sokol Haziri-unë vërejtjet i thash dhe jam plotësisht në pajtim me kryetarin që kjo çështje duhet të shtyhet. Ta bëjmë një rregullore origjinale e cila është e Gjilanit!

Sadudin Berisha- u dha një kualifikim i cili nuk qëndron. Unë kujtoj se duhet të merret kjo shumë, shumë serioze nga dispozitat hyrëse dhe dispozitat të cilat janë dhënë në propozim për propozim dhe miratim Kuvendit. Lexoni mirë nenin tre, nenin 4 dhe nëse do t' i emërtojmë individualisht për këtë, për këtë do t' mbushim disa faqe dhe sërish do të na mbetët dikush për pa u përfshirë!

Në nenin 4 thuhet "Nderi i Qytetit" (i cili nen u citua na z. Berisha) u tha nga kryetari se mungojnë shumë tituj, nuk mungon asgjë, por urdhëroni, gjene, interpretone dhe zbatone!

Absolutisht çdo gjë është e përfshirë, por nëse ju dëshironi t' i citoni titujt është dika tjetër, por këtu janë të gjitha dhe asgjë nuk është e kufizuar.

Janë përcaktuar procedurat të cilët si tituj kalojnë përmes Kuvendit të Komunës në miratim dhe në formalizim të një titulli të tillë të cilat tituj, mirënjohje, falënderime nuk ka nevojë të kalojnë në KK, por përmes Komisionit drejtpërdrejtë, kryetari i Komunës i finalizon.

Prandaj kujtoj se duhet me shumë kujdes, lexoni dispozitat brenda se çka shkruan interpretoni, mandej mund ta shihni se a mungon diçka apo jo?

Bahrie Veseli- në nenin 6 lejon që të përfshihen edhe personalitetet e tjera si dhe profesionet e tjera, mirëpo unë mendoj se mungon dhe nuk është përfshirë edhe lëmi i arsimit, sepse meriton që të hyjë këtu edhe "arsimtari më mirë". Është në rregull kur shpërblehet një sportist i dalluar, por a është në rregull nëse nuk e shpërblejmë një biznesmen i cili mban dhe kujdeset për familje skamnore me numër të madh të anëtarëve. Gjithashtu edhe unë pajtohem me kryetarin i cili tha se është mirë që të përfshihen edhe lëmitë e tjera.

Arben Malqi- nuk desha fare të diskutoj për këtë çështje, por më nxiti kryetari dhe kolegja Bahrie, kur u përmend sportisti i vitit. E them me plotë përgjegjësi se kjo është gjëja më e mirë që po shoh këtu! Këtë po e them se fëmijët t' i orientosh me sport është e ditur se fëmija është i shëndosh dhe ata fëmijë kanë shpëtuar nga gjërat negative si është narkomania për të cilën dukuri negative Gjilani e zë vendin e dytë.

E dyta çfarë kushte dhe predispozita kanë sportistët e Gjilanit dhe tërë Kosovës, këtë e dini shumë mirë dhe duhet ditur se ambasadorët më të mirë të një shteti janë sportistët.

Unë shumë shtete botërore i kam njohtë përmes sportistëve të mëdhenj që i kanë, por dhe luftën e kanë ndihmuar më së shumti sportistët në të gjitha vendet e regjionit.

Prandaj, këtu unë i përgëzoj ata të cilët e kanë bërë këtë punë dhe të cilët e kanë fut këtë mirënjohje të veçantë të cilën unë e çmoj shumë. Urime dhe suksese, ka mangësi, por ne do ta votojmë.

Tahir Arifi- unë pajtohem me atë që kjo duhet të shtyhet, sepse fillimisht ne nuk e kemi lexuar shumë së pari këtë projekt –rregullore. Unë e kam këtë bindje dhe realisht nuk po na prenë sopata shumicës me një vend, aty ku duhet për të na prerë.

Duhet shtyrë se megjithatë Komuna duhet t' i ndajë disa falënderime, mirënjohje, ka dhënë Drejtoria e Arsimit për mësuesit, Drejtoria e Kulturës nuk e di nëse komisioni është konsultuar me Drejtorinë e Arsimit, sepse Drejtoria e Kulturës në fund të vitit gjithmonë i ndan disa mirënjohje, por i ka dhënë Drejtoria e Arsimit. Kjo çështje duhet të precizohet më saktë se cilët duhet të jenë ata njerëz të cilët do të shpërblehen në fund të vitit me një

mirënjohje dhe falënderim. Nuk duhet lënë asgjë që pastaj kujt i teket të jap një mirënjohje ose falënderim.

Me këtë rregullore përcaktohet saktë se kush e ka autoritetin për ta dhënë një falënderim ose mirënjohje dhe duhet precizohet se cilat nga këto akte duhet të kalojnë në KK dhe cilat nga këto akte, kalojnë përmes drejtorisë të kryetari etj.

Sadudin Berisha- pajtohem me parafolësin se nuk është lexuar rregullorja dhe për këtë arsye epen kualifikime paragjyquese për pa e parë në brendi se çka kemi! Sportist i vitit është veçuar nga komisioni si një rast i veçantë që i epet një njeriu i cili i ka bërë më së shumti nder Gjilanit. Mirënjohjet shumë qartë thuhet dhe kemi pasur një alternativë tjetër të përcaktimit të emërtimeve, nxënësi më i dalluar, sportisti më i suksesshëm, arsimtari i dalluar dhe shumë e shumë të tjera dhe kanë dalë 10-15 raste, por në fund është vlerësuar se me një dispozitë të gjitha këto kategori përfshihen (të cilat raste z. Berisha i citon nga nenin 4). Plotë tituj ka se kujt i ndahen dhe pse i ndahen, por këtu nuk përfshihet mundësia që drejtorit të ndajë mirënjohje. Mirëpo mirënjohjet “Qytetar Nderi” dhe “Nderi i Qytetit” i epet mundësia vetëm kryetarit të Komunës së bashku me KK, përmes procedurave të përcaktuara.

Te mirënjohjet është një përjashtim, sepse mirënjohjet nuk epen në çdo vit, por në çdo datë të shënuar gjatë vitit kalendarik. Kryetari i Komunës duke respektuar procedurat përmes komisionit për pa hyrë në procedurë formale të KK-së i ndan ato mirënjohje.

Këto janë norma juridike, duhet lexuar me vëmendje. Këto janë norma juridike, këtu nuk shkruhen vjersha.

Qemajl Mustafa- “Qytetarë Nderi” është “Nderi i Qytetit”, është “Sportisti i Vitit”, dhe janë mirënjohjet, nuk janë as falënderimet. Unë po iu pyes si do të ndihet artisti i dalluar? Si do të ndihet studenti i dalluar? Si do të ndihet nxënësi i dalluar? Nuk është punë e rëndë kjo, prandaj mund të uleni edhe njëherë dhe ta sillni në seancën tjetër.

Izmi Zeka- për ta arrit një koncenzues, po propozojmë që ta shtyjmë për seancën tjetër, por vërejtjet që janë të deponohen te komisioni për akte normative. Vërejtjet të dërgohen deri në javën tjetër. Duhet ta kenë të qartë se titujt janë të veçantë, sikurse presidentja që e ka të drejtën për të shpallë dëshmorë dhe heronj të kombit janë të veçantë dhe nuk hyjnë të gjitha kategoritë.

Pra edhe kjo pikë shtyhet për seancën e radhës.

5. Projekt Rregullorja për kompensim të pagës për ish zyrtarët e lartë të Komunës

Izmi Zeka – kjo rregullore është debatuar disa herë, kurse sot kërkoj që të përfshihen edhe drejtorët, kurse të tjera janë në rregull.

Arben Mehmeti – është qëndrimi i ynë edhe nga seanca e kaur që këtu nuk duhet të përfshihen drejtorët, kurse për të tjerat pajtohem.

Izmi Zeka- kush është për propozimin që e bëra unë që edhe drejtorët të jenë pjesë e kësaj?

Aprovohet pika 5 e rendit të punës; Projekt Rregullorja për kompensim të pagës për ish zyrtarët e lartë të Komunës, me 24 vota të anëtarëve të Kuvendit.

6. Marrëveshja investuese për ndërtimin e objektit afarist-banesor te Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim

7. Marrëveshja investuese për ndërtimin e objektit afarist-banesor te Kombinati i Duhanit në Gjilan

Izmi Zeka- këto dy pika ne i kemi debatuar disa herë nëse dikush dëshiron mund ta merr fjalën.

Arben Mehmeti – së pari kjo nuk është debatuar dhe z. kryesues nuk qëndron ajo që po e thoni ju! Në KPF ka kaluar formalisht me qëndrim hajt se bisedojmë në Kuvend! Ne kemi pasur shumë gjëra për t’i thënë në komitet, por nuk na është dhënë mundësia, kështu që këtu është mundësia t’i themi ato që mendojmë si grup i LDK-së.

Ne e kemi pasur mendimin edhe në të kaluarën që ky projekti i PP-së, duhet të jetë në harmoni me ligjet aktuale në fuqi dhe përderisa nuk ndryshohet Ligji mbi PP dhe i cili do t’i kishte mundësuar dhe të drejtën e banimit nëpër këto projekte, në këtë formë si është ofruar, është i paligjshëm, do të thotë nuk e ka bazën juridike.

Me ligj parashihet që të konsultohet dhe të ketë ndonjë shkresë zyrtare nga MEF-i, nga Njësia për monitorim të këtij partneriteti të cilin unë nuk e kam parë që kemi ndonjë pëlqim në këtë aspekt! Këtu është vetëm një Komision i cili e ka bërë një negociim me kompanitë të cilat kanë konkurruar për t’i ndërtuar këto objekte, për të cilin rast mendoj se këtu është një shkelje e rregullave në fuqi, sepse konkurrenca nuk është adekuate dhe me një ose dy kompani të hyhet në këso projekte të mëdha për mua është e pajustificueshme.

Për derisa është kjo situatë e parregulluar ligjore për këtë çështje, unë mendoj se ky dokument nuk do të duhej absolutisht të jetë në Kuvend, derisa mos ta kemi një qëndrim zyrtar nga MEF-i, gjegjësisht, Njësia për monitorim.

Mirëpo për pa hyrë në përmbajtje këtu, sepse edhe përmbajtja nuk është interes i Komunës, sepse kemi një disproporcion në mes investitorit privat dhe Komunës. Do të thotë është një përgjegjësi e vogël që i mbetet Komunës në këto projekte e që do të duhej të ishte ndryshe.

Komuna do të duhej të ishte më e privilegjuar dhe të ketë pasuri dhe të ketë hapësira më të mëdha në këto projekte nga ajo e cila na është ofruar këtu. Do të thotë Komuna nuk e gëzon tretmanin e një subjekti serioz e që do të jetë me rëndësi për të ardhmen.

Në përgjithësi kjo në aspektin ligjor është e parregulluar juridikisht dhe për derisa nuk është e rregulluar edhe ne si Kuvend do të duhej të ishim të rezervuar në këtë aspekt!

Nuk kemi ndonjë informatë sa i përket aplikantëve se kush ka aplikuar në këto projekte, cilat janë ato kompani dhe nga ajo që bëhet fjalë këtu si p.sh. te Kadsatri “Ari Tradingë”, është një kompani e përzier me Gjilan dhe Prishtinë nëse nuk gaboj?

Ajo që e shton dilemën për shkelje eventuale të ligjeve në fuqi është edhe një arsye tjetër që e kam parë se tash fillon të bëhet një renovim në objektin këtu në Komunën e Gjilanit me të cilin rast parashihet të bëhet transferi i Drejtorisë së Kadsatrit në një objekt tjetër. Ne ende nuk e kemi marrë një vendim të tillë, nuk e kemi aprovuar, kurse dikush ka filluar renovimin ose ndërtimin e një objekti për ta transferuar selinë e Drejtorisë së Kadsatrit.

Për mua kjo është një veprim i cili do të duhej të shikohej me kujdes, por nëse ia shtojmë edhe tjetrën që pronari “Art Trading”, vjen nga vendbanimi i kryetarit të Komunës dhe bashkëpronari i kësaj kompanie është një nga njerëzit kryesor i cili e ka financuar fushatën parazgjedhore të PDK-së dhe të kryetarit aktual. Mandej në bazë të informatave shitesë të cilat i posedojmë, pikërisht kryetari i Komunës është edhe borxhlinj indirekt i kësaj kompanie!

Për neve do të ishte e pajustificueshme nëse nuk i themi gjërat ku duhet të thuhet e që nesër mos të dalin nëpër medime publike ose në ndonjë organ tjetër për të thënë atë që duhet të thuhet këtu.

Unë e kam për obligim t' i them para Kuvendit këto dyshime që i kemi dhe do të ishte mirë që të rishqyrtohen këto marrëveshje, të kthehen prapa dhe të riprocedohen në harmoni me ligjin dhe në pajtim të plotë me Njësine për monitorim të MEF-it!

Këto vlerësime i kemi nxjerrë nga informatat e ndryshme dhe nga ajo që po shohim në praktikë, se çka është duke ndodhur. Për këtë kërkojmë nga ky Kuvend që këto marrëveshje të shtyhen për seanca të tjera të radhës dhe të konsultohet jashtëzakonisht mirë ligji, me qëllim që mos të bëjmë ndonjë veprim antiligjor.

Izmi Zeka- këtu pat debat interesant dhe në bazë të kësaj që u tha këtu, juristët që i kemi në Komunë duhet larguar! Nuk ka nevojë, kemi juristë në Kuvend, sepse ato këtu po i bëjnë shkresat, pastaj opozita po mban ligjërata. Dokumente të cila vijnë këtu, ato e kanë një skaner dhe juristët i shikojnë, kemi apo nuk kemi të drejtë? Edhe njëherë z. Arbenit po i them se ne mbajmë përgjegjësi, edhe nëse e shkelim ligjin ne mbajmë përgjegjësi! Më duket se fare për pa e lexuar ligjin, po thoni u shkel ligji!

Qemajl Mustafa- së pari nuk e di se ku kanë luajtur gurët, sepse ne këto partneriteti i kemi votuar me koncenzues të plotë. Ne kemi votuar disa herë, jo njëherë! Tash është kjo faza përfundimtare e votimit të propozimit të këtyre dy kontratave e që afërisht janë të njëjta, sepse natyra e punës është e njëjtë dhe pritet nëse shkon mbarë e mirë puna e Higjienës.

Unë po e kuptoj se jemi në fazën e konsolidimit të mendjes politike dhe të asaj profesionale, të gjitha po i kuptoj dhe nuk jam i irrituar prej kësaj mënyre të qasjes së Arbenit.

Ne po e degradojmë procesin, sepse me këtë punë po merremi që një vit dhe çdo gjë ka qenë e hapur dhe çdo gjë prapë është e hapur. Keni kërkuar që KPF të jetë trup monitorues, por jo vetëm monitorues, por edhe vlerësues. Ai komitet cili për mua është i shumtë, sepse nuk duhen më njerëz aty, por keni propozuar ne kemi pranuar. Ai bën edhe përcaktimin bashkë me investitorin për caktimin edhe për rimatje nëse duhet çdo herë të hapësirave dhe hises që i takon pjesës publike dhe pjesës së investitorit. Ai bën përcaktimin e çmimit të secilit kualitet të asaj hapësire. Praktikisht ky komitet e bën monitorimin total edhe të organit mbikëqyrës teknik dhe të tërë procesit financiar deri në centin e fundit dhe deri në realizim final të kësaj kontrate. Nga kjo po shihet se kontrata është e hartuar jashtëzakonisht në mënyrë profesionale, jashtëzakonisht në detale dhe asgjë nuk iu është lënë rastit. Kontrata thirret në ligjin e caktuar në fuqi. Ne kemi konsultuar disa herë Njësine për monitorim në kuadër të MEF-it në Prishtinë vazhdimisht, të cilin fakt e kam thënë disa herë.

Nga këto konsultime ekzistojnë përgjigjet nga kjo njësi dhe është bazuar atje ku duhet bazuar, do të thotë në Ligjin për PP dhe është bazuar në Ligjin e pronës, atje ku lejon ligji për të u bazuar. Është bazuar në Ligjin e dhënies së tokës në shfrytëzim atje ku lejon ligji dhe nuk është asgjë në këtë aspekt kundërligjor.

Hisja është shumë e madhe, sepse unë iu kam thënë se duhet të jetë edhe më e vogël që vetëm e vetëm t' i tërheqim investitorët në këtë Komunë. Është e madhe, sepse vendet janë atraktive, janë vende të mira. Do të shihni kur ta shpallim të "Iliria" vjen ndonjë ose asnjë, sepse vendi nuk është atraktiv.

Sa i përket pronarëve unë mbrëmë vonë e kam pasur në takim vonë Fadilin pronarin e "Agrohermesit", ai është një investitor i mirë jashtëzakonisht pedant i cili ka kërkuar për të qenë pjesë e investimeve në hapësirat e ardhshme publike në Gjilan. Unë e kam inkurajuar në secilin rast, sepse unë kërkoj investitorë. Ky Kuvend duhet të kërkojë dhe t' i hap mundësi të

gjithë investitorëve, unë kam shumë respekt për te dhe për të gjithë të tjerët që po investojnë në Komunë. Nuk e di unë përkatësin politike të atij Nijaziut (Xhaxhit), nuk e di përkatësinë politike të atij Agronit që punon me te, por e di shumë mirë të këtij Selimit, por ky Kuvend nuk lejon t' i krijojë dikujt barriera për shkak të prejardhjes së tij politike dhe të çfarëdo akti tjetër pozitiv.

Sa i përket prejardhjes politike, unë nuk kam probleme fare, a është investitori prej vendlindjes sime apo dikujt tjetër, kjo nuk do të më bëj përshtypje fare. Unë do të dëshiroja të jenë nga të gjitha anët e Komunës para së gjithash dhe nëse jo prej Komunës të jenë jashtë Komunës, por nëse qëllonjë nga Malisheva, jo që do të jem kundër, por jam për. Dëshiroj që të ketë në Malishevë këso investitorë që mund të hyjnë në këto partneritete. Mirëpo raportet private nuk janë për debat në këtë Kuvend, ndoshta edhe Arbenit i kam diçka borxh ose ai më ka mua, por ato janë raporte private.

Riad Rashti- mua më vjen keq për qëndrim total të paarsyeshëm të Arbenit, por së pari po i falënderoj institucionet komunale dhe kryetarin e Komunës për çmimin që kanë marrë prej USAID-it për këtë qëllim. Do të thotë për krijim të klimës së favorshme për biznes në Gjilan. Kjo për mua është krenari për të arriturat e Gjilanit.

Sa i përket shkeljeve ligjore që i tha z. Arbeni i cili thirret shpeshherë në ligje, asnjëherë nuk ka sjell dëshmi se kur ku dhe cili ligj është shkelur, por ka pasur vetëm fjalë!

Sa i përket procesit të "Higjienës" më ka ra shumë herë për ta lexuar Ligjin e PP-së e di shumë mirë se në ofertat në të cilat konkurrojnë për këto investime nuk kërkohet, nuk thirret ligji i prokurimit dhe mundet që vetëm një ofertues nëse i ka plotësuar kriteret dhe dokumentacionet e nevojshme Komuna mundet të lidh kontratë për realizim të një projekti të tillë.

Ndoshta bëra gabim që e mora fjalën, sepse edhe unë jam i Malishevës, por do ta ndërroj vendbanimin dhe do të dal në Gjilan.

Sa i përket dilemave të ofertuesve t' i lënë më vonë, në kohë të fushatës dhe të përgatitet më mirë dhe t' i sjellin disa argumente të "Bukuroshja" e qytetit e cila u debatua disa herë, sa ofertues ka pasur dhe sa investime janë bërë? Pasi po merremi me politika të mëdha, më mirë z. Arbeni të jep këshilla të tilla në Prishtinë se si të përmirësohet ambienti dhe si të investohet në Prishtinë. Në këtë komunë ka humbur investimi prej 14 milion euro të cilat kanë shkuar në Mitrovicë për shkak të pengesave të cilat i ka pasur Komuna e Prishtinës.

Arben Mehmeti- unë me profesion jam avokat, sepse e kam përfunduar avokaturën dhe nëse e mbroj dike është më me arsye, por ekonomistëve kjo nuk iu takon! Riadit nuk i takon shumë për t' u marrë me ligje, por as mua nuk më takon të merrem me LDK-në e Prishtinës dhe ne mund të merremi me këto problemi për të cilat paguhemi për t' u marrë.

Unë po i përmendi vetëm dy raste i cili po thotë asnjëherë nuk ka sjell dëshmi, por vetëm po flet. Një nga dëshmitë e para është kryesuesi i Kuvendit për të cilin ju e dini shumë mirë, kur është zgjedh në mënyrë të paligjshme të cilin rast ne e kemi kontestuar dhe i cili fakt është rikthyer në Kuvend për shkak të shkeljeve ligjore. E dyta më e freskët është se vendimi i Urbanizmit për "Fidanishten" në seancën e KPF-së ku ka qenë Riadi prezent dhe të kam treguar se gabimisht është baza juridike dhe tash është një vendim tjetër që është bazuar me disa nene të tjera të ligjit dhe nëse nuk është argument për të treguar që janë veprime konkrete është tjetër çështje? Kurse Riadi prej Malishevës e ka problem të vijë në Gjilan për shkak se unë në Malishevë jam informuar se ta kanë sjell asfaltin deri te serra në oborr.

Riad Rashiti-unë nuk jam as avokat as juristë, por ligjin të cilin e citoi Arbeni e kam lexuar shumë mirë dhe e di se si është për këtë lëmi.

Sa përket vërejtje për dy vjet, z. Arbeni i ka dhënë dy vërejtje për të cilat paska pasur të drejtë, kurse në çdo seancë thotë se nga 12 ligje janë thyer, kurse për dy vjet dolën dy ligje.

Sa i përket asfaltimit. Z. Arbeni ta dijë se te lagja ime asnjë metër katror nuk është shtruar, sepse asfalti është shtruar, më 2004 kur ka qenë tjetër kush në pushtet.

Ejup Haziri- desha të reagoj në fillim, por pjesën më të madhe që pata për ta thënë e tha kryetari. Pikërisht te përqindjet e ndara, unë e di që në Prishtinë është një qendër shumë më madhe për të cilën manipulohet. Ajo që desha ta them se tash është bërë Malishevë e Llocë , desha të reagoj si i Bresalcit për ta ndërruar territorin dhe t'ia jap një shembull Arbenit që të kërkoj si shef i grupit, realisht të jesh pak më parimor! Ne duhet të bëjmë politika, por politikë e cila mbështet mbi parime dhe mbi argumente. Si shembull dua ta jep e ke njeriun afër ul i cili i jep vërejtje dhe i bazon, prandaj edhe prej teje herëve tjera na i argumento, sepse etiketimet që i bëre sot janë pahijshme dhe nuk kisha desh në të ardhmen të shoh me një pozitë të tillë!

Arben Mehmeti- së pari po i përgjigjem Ejupit, sepse ky së pari në mënyrë joligjore dhe në mënyrë të kundërligjshme është anëtar i këtij Kuvendi, sepse ky jeton në Komunën e Novo Bërdës! Ne nuk kemi hyrë në këto gjëra dhe po e llogarisë se kjo është e treta për këto dy vjet, sepse dy i tha Riadi, kjo është e treta.

Ramiz Ramadani- unë kam pyetje për kryetarin të cilin e dëgjova me kujdes dhe e kisha lut të më dëgjoj. Kryetari e tha se PP që ju i thatë, kanë kaluar me koncenzues të plotë dhe kjo është e saktë dhe unë e kam marrë përgjegjësinë për të kaluar me koncenzues të plotë, sepse është përgjegjësi edhe e jona për t'u zhvilluar qyteti, nuk jemi ne më pak përgjegjës se ju që jeni në pushtet. Ne kemi qenë të vetëdijshëm se për t'u zhvilluar ky qytet është PP, por dilema jonë dhe kundërshtimi jonë ka qenë te objekte afariste, te objektet e banimit i cili fushëveprim është i pa qartë për mua? Në momente që ju z. Kryetar i keni ofruar projekte, unë e kuptoj se janë ideore për vendin që i keni ofruar projekt e që është një kompleks afarist që me të vërtetë është jashtëzakonisht i mirë dhe me përmbajtjen teorike që e ofron, ky objekt afarist është vendos aty dhe ruan atë pamjen e qytetit, urbanizmit që në të vërtetë kam desh ta vlerësoj.

E kuptoj se investitori ose ai partneri mund të bëjë ndryshime ai i ka planet tjera, por prapë duhet t' i përmbahet kësaj. Këto janë të njohura 3850 metra katror janë afarizëm, banim këtu nuk ka asnjë metër katror dhe ashtu ka kaluar ky projekt. Tash bëhet fjalë për një projekt i cili ka 1650 metra katror afarizëm dhe 2200 banim. Vërejtja ime është dhe të kërkoj falje 100 ose 200 herë, por nuk di t' i interpretoj ndryshe përveç mashtrim! Na keni ofruar diçka tjetër tash po realizohet diçka tjetër! Cili është interesi i qytetarit? Së pari ky objekt është menduar për administratë të Gjeodezisë dhe ndoshta ndonjë pjesë tjetër të Komunës për ta vendos aty . Objekti i Gjeodezisë i ka diku 450 metra katror, tash dhe Inspeksion 150 gjithsej 600metra katror. Me këtë partneritet ne i fitojmë 462 metra katror hapësirë afarizëm, por prapë i humbim 150 dhe inspeksioni nuk ka shans të vendoset aty. Mund të fitojmë banesa, por objekte afarizëm na takojnë 28% dhe prej 1650 metra, neve na takojnë 462 m.

Me të vërtetë për këtë shmangie kaq të madhe kisha desh një arsyetim ?

Qemajl Mustafa-së pari ato kanë qenë propozime ideore, por është me rëndësi që atje ka vetëm 10 ari tokë dhe është me shumë rëndësi për ata që e kuptojnë hapësirën, shfrytëzimin e saj, perceptimin e ndërtimit për t' i shfrytëzuar profesionalisht hapësira dhe për të ardh investimet në atë vend. Nëse nuk është shkruar aty afaristo- banesor, sepse sinqerisht nuk e di, është një lëshim. Por në ndërkohë nëse investitori ka vlerësuar që nuk mund ta komercializojmë si

afarizëm dhe ka ndërruar qëndrim prapë është legjitime, prapë është legale, ne nuk po fshehim asgjë. Ja ku është kontrata, prandaj kurrfarë mashtrimi këtu nuk ka ! Ka ridizajnim të përcaktimit të investitorit bashkë me autoritetin kontraktues e cila është Komuna. Kontratën nuk e kemi nënshkruar ende, ajo është fjalë e rëndë, kur thuhet kryetari i Komunës po e mashtron Kuvendin është fjalë e rëndë. Kjo është ofendim dhe për këtë unë kisha desh që Ramizi së paku ta bëjë një kërkim-falje para të njëjtit organ.

Ndërsa sa i përket Kadastrit, askund nuk është thënë dhe nuk keni për ta gjetur asnjë të vetmen fjali që në këtë objekt kthehet Shërbimi i Kadastrit dhe Inspeksionit. Nëse e gjeni këtë, unë po e pranoj që është mashtrim, por nuk keni për ta gjetur. Absolutisht ky zhvillim e ka një kahe nuk ka kthim prapa nuk është zhvillim dy kahe. Kadastru kalon në objekte të tjera dhe unë do të dëshiroj që së paku me ato kushte që i kanë sot, të kalojnë në ndërtesën e ardhme të Komunës, sepse kjo Komunë jeton në 9 objekte të ndryshme.

Biblioteka që po ndërtohet sot po ndërtohet si alternativë për shkak të mungesës së lokacionit për ndërtesën e Komunës, sepse përndryshe ne do ta kishim filluar në vjeshtë ndërtesën e Komunës dhe jo Bibliotekën Rajonale. Në ndërkohë unë shumë besoj i besoj vetes sime dhe i besoj trendit pozitiv të ardhjes së investimeve në këtë Komunë.

Ne do ta fillojmë ndërtesën e komunës sa më shpejtë që të jetë e mundur porsa të lirohet lokacioni, do të thotë, Burgu i Qarkut, gjykatat dhe Policia.

Prandaj është një ripërcaktim i investitorit, sepse ka dyshuar se a do të mundet ta shes hapësirën afariste? Mund të shiten hapësirat afariste në përdhës dhe katin e parë, por jo edhe në katet më të larta. Kjo është ajo që desha për ta sqaruar!

Ramiz Ramadani- unë kam respekt për kryetarin dhe të jeni të bindur se nuk kam tendencë kur e thash atë fjalë, kërkova paraprakisht falje dhe përsëri po të kërkoj dhe kjo absolutisht nuk më pengon. Mirëpo mendoj kryetar se nuk ke të dejtë, sepse edhe atëherë e kemi ditur se kjo do të jetë e vështirë për t' u realizuar, është e vështirë, por me shumë interes. E kuptoj se ndryshimi ndodh e di që është ideor, por ndryshimi duhet mos ta ndërrojë të tërë substancën. Mund të ndërrohet deri në 10% ose 15% për interes të investitorit, por prej 3850 m afarizëm dhe me asnjë metër banim, tash po ndërrohet e tëra, në të kundërtën, sinjerisht nuk e kuptoj. Unë atëherë kur ke propozuar kam besuar dhe për atë e kam përdor atë falë, por tash për të njëjtën nuk e thatë se është ndërruar komplet objekti. E ka pasur për borxh kryetari që ta thotë se ai objekt të cilin unë e kam prezantuar nuk është më, por është një tjetër, atëherë çdo gjë do të ishte e qartë.

Qemajl Mustafa- me njohurit e mia absolutisht është ruajtur shfrytëzimi i hapësirës edhe horizontalja edhe vertikalja, do të thotë është ruajtur ajo masë e sipërfaqes që do të duhej të mbulohet me ndërtim dhe është bërë vetëm ripërcaktim për investim. Ne si Komunë na ka pëlqyer atëherë për të pasur një objekt afarist aty. Mirëpo si t' ia bëjmë nëse ai investitori i cili i sjell parat dhe kanë ardhur konkurrenca dhe thotë unë nuk e marrë përgjegjësinë për ta bërë këtë ose atë? Nëse investitori nuk ka mundësi për ta shit, ai nuk i investon miliona euro në objekt! Kjo është shumë e natyrshme, prandaj duhet të keni konsideratë në këtë punë.

Nga projekti ideor thuhet edhe në ligje deri te ai ekzekutues mund të ketë ndryshime! Prandaj leja e ndërtimit nuk epet duke u bazuar në projektin ideor, por epet në disa kushte urbanistike me projektin ekzekutues i cili mund të ketë lëvizje të lejueshme.

Keni konsideratë, sepse nuk vijnë investimet. Unë do të kisha dëshiruar, ky qytet ta ketë rëndësinë e Prishtinës, por nuk e ka. Taksa ndërtimore në Prishtinë është 36 euro për metër katror e jo 12 si e kemi ne, banalisht lirë. Mirëpo Prishtina është diçka tjetër, aty

paraprakisht shiten hapësirat, kurs enë Gjilan nuk ec kjo punë. Duhet pasur shumë konsideratë për ata që marrin guximin për të investuar.

Izmi Zeka – mendoj se debatuar gjatë, prandaj kush është për aprovim të këtyre dy marrëveshjeve të PP-së ?

Aprovohet pika 6 dhe 7 e rendit të punës: Marrëveshja investuese për ndërtimin e objektit afarist-banesor te Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim dhe Marrëveshja investuese për ndërtimin e objektit afarist-banesor te Kombinati i Duhanit në Gjilan me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit, 8 ishin kundër, kurse 3 ishin abstenime

8. Autorizimi i KPF për monitorimin e implementimit të marrëveshjeve në PPP

Izmi Zeka – kjo pikë është debatuar, prandaj kush është për aprovim ?

Aprovohet pika 8 e rendit të punës: Autorizimi i KPF për monitorimin e implementimit të marrëveshjeve në PPP me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 8 ishin kundër

Izmi Zeka- z. Arben Mehmeti nuk pat kuptim ky votim, sepse nëse dikush ka qenë propozues i kësaj pike, ke qenë ti! Unë këtë e kam mbështet për hir të një transparence dhe të tërë punës dhe tash del këtu propozim yt, kurse ti nuk e voton!

9. Bazat për bashkëpunim ndërmjet Komunës së Gjilanit dhe Bashkëpunimi Evropian për komunat më të fuqishme

Izmi Zeka- materialin lidhur me këtë pikë e keni, prandaj iu lus që të deklaroheni se kush është për ta aprovuar këtë pikë?

Aprovohet pika 9 e rendit të punës: Bazat për bashkëpunim ndërmjet Komunës së Gjilanit dhe Bashkëpunimi Evropian për komunat më të fuqishme me vota unanime të anëtarëve të kuvendit.

10. Propozim vendimi për kompensimin e Komisionit për çështje statutare

Izmi Zeka- është debatuar edhe kjo pikë, kush është për aprovim?

Aprovohet pika 10 e rendit të punës: Propozim vendimi për kompensimin e Komisionit për çështje statutare, me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

11. Propozim vendimi për caktimin e lartësisë së kompensimit të Komisionit për çështje statutare dhe akte normative

Izmi Zeka- kjo është për akte normative, nuk është për çështje statutare, është komision i rregullt, jemi marrë, vesh kush është për aprovim?

Aprovohet pika 11 e rendit të punës: Propozim vendimi për caktimin e lartësisë së kompensimit të Komisionit për çështje statutare dhe akte normative me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

12. Autorizimi për Kryetarin e Komunës së Gjilanit për propozimet e ndërrimit të pronave komunale me ato shoqërore

Izmi Zeka- është propozuar në KPF që të autorizohet kryetari, që kur ka nevojë për ndërrim të pronës me AKP-në, kryetari të propozojë, pastaj të vijë në Kuvend
Kush është për këtë propozim?

Aprovohet pika 12 e rendit të punës: Autorizimi për Kryetarin e Komunës së Gjilanit për propozimet e ndërrimit të pronave komunale me ato shoqërore, me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

13. Informatë rreth provimit shtetërorë të maturës,

Izmi Zeka- për këtë pikë materiali është, nëse dëshironi mund të hapim debat, por kjo është vetëm informatë.

Sadudin Berisha- unë kërkoj nga shefat e grupeve politike që kur të kërkojnë informata nuk hapet debat, për këso raste vetëm informohet Kuvendi, kurse debat nuk hapet.
Kur është qëllimi për të hap debat për çështje të caktuara, atëherë mund të debatojmë.

Sokol Haziri- unë nuk jam në pajtim fare me këtë çështje, sepse ne nuk jemi këtu dëgjuese pasivë, nuk votojmë për raste të tilla, por debat dhe sqarime rreth informatës gjithsesi duhet të ketë.

Ramiz Ramadani- kur konstatohet se duhet edhe informata të debatohet për shkak të rëndësisë mendoj se duhet ndalur dhe sqaruar disa çështje. Unë e kam parë tabelën e suksesit të nxënësve dhe si përfundim rezultati përgjithësisht është i dobët, por gjendja dramatike është te Shkolla e Mesme e Bujqësisë, për të cilin rast drejtori duhet të na jep një sqarim, sepse rezultati është totalisht i papranueshëm. Prej 254 nxënës ne posedojmë informata se vetëm 3 e kanë kaluar provimin, prandaj kjo është për brengosje të skajshme.

Ajo që dua ta bëj një krahasim është se te Gjimnazi e kemi rezultatin 67.18, më obligon të bindem se në këtë shkollë, personelin e kemi të mirë, në nivel, kurse te Shkolla e Bujqësisë konsideroj se personali është i papërgjegjshëm dhe nuk është në nivel të detyrës.

Në kushte të këtij rezultati, gati se shpallet gjendje e jashtëzakonshme. Nuk po kërkoj luks, por në Suedi ministri i Transportit jep dorëheqje për 13 minuta nëse vonohet treni. Nuk po e kërkoj këtë luks, por së paku kjo duhet të alarmohet.

Arben Maliqi- në këtë rast duhet kërkuar një zanafillë më detale pse ka ardhur deri te kjo gjendje. Jemi të vetëdijshëm se dhe këtë vit pranohen 10 klasë në Mjekësi, në Gjimnaz dhe Ekonomike, kurse në Shkollën e Bujqësisë shkojnë nxënësit të cilët nuk janë askund me sukses. Nuk është në pyetje kolektivi, sepse unë vitin e kaur kam arrit një marrëveshje me kryetarin e Komunës dhe jam mësimdhënës edhe në Shkollën Ekonomike dhe të Arbërisë, është një kolektiv për lakmi aty punohet, mirëpo nxënësit janë të kategorisë më të ulët, këtë po e them me shumë bindje. Aty shkojnë ata nxënës të cilët kanë mbetur askund, kurse gabimi i ynë është se ne i pranojmë nga 44 nxënës. Unë në Shkollën Ekonomike i kam në një klasë nga 44 nxënës, e cila dukuri është pesim për mësim.

Të jemi të vetëdijshëm, mos ta rrisim numrin e nxënësve, të jenë në një klasë nga 35 nxënës më së shumti. Nuk dua ta lëndoj askënd dhe në bazë të kushteve që janë aty punohet, mirëpo janë në pyetje nxënësit të cilët janë shumë të dobët.

Unë iu lus që tash e tutje që nga 35 nxënës të jenë në klasë, sepse në Mjekësi edhe këtë vit numri i nxënësve është i madh. Çka na duhen neve 450 motra medicinale, pse 10 klasë nuk e kam të qartë, çka duam të bëjmë me të? T' i kushtojmë rëndësi bujqësisë, sepse prioritet është bujqësia dhe le të angazhon nxënësit e mirë.

Edhe njëherë kërkoj nga drejtori, kryetari i Komunës, nga ministria që asnjë klasë mos të ketë mbi 35 nxënës.

Shkëlqim Latifi- unë dua të shtoj se ne në Komitet të Arsimit e kemi debatuar këtë çështje dhe rezultati nuk është shumë i kënaqshëm (48%). Kemi konstatuar se ka pasur disa parregullsi sa i përket administruesve, por megjithatë është një rezultat i kënaqshëm.

Rashit Sahiti- unë e kam thënë në komitet të Arsimit dhe po e them edhe këtu, por i thanë edhe kolegët tjerë dhe këtu dalin ato defektet të cilat po na përcjellin. Testi i maturës i cili ka filluar të aplikohet që nga viti 2007 nga Ministria e Arsimit dhe deri në ditët e sotme, në vend se të tregoj sukses, deri më tash ka treguar dobësi të eksperimentit.

Unë po e them se ky është eksperiment, por nëse dikush dëshiron për ta justifikuar fjalën eksperiment, unë e kam një fjalë pak më të rëndë, sepse kam arsye për këtë.

Ky sukses na jep për të kuptuar se arsimit në shkollat e mesme ka probleme shumë serioze dhe përgjegjës për këtë në radhë të parë janë prindërit, menaxherët e shkollave, mësimdhënësit, drejtoritë komunale, në fund edhe Ministria e Arsimit.

Në kohën e ngritjes së institucioneve pas luftës u përbuzën shumë kuadro në shkolla, sepse shkollat u zhveshën nga pedagogët, psikologët dhe stafi tjetër pedagogjik i cili ka ekzistuar.

Janë përpiluar plan-programe nga persona joprofesional, filluan eksperimente me arsimin e mesëm dhe universitar, shkollat u zhveshën nga entet pedagogjike rajonale dhe inspektoratet e arsimit. Një inspektoriat në Komunën tonë ekziston, por ai i ka vetëm 8 punëtorë, por të cilët nuk janë ekspert për të gjitha lëndët mësimore, sepse vjen një inspektor i cili nuk ka lidhje me lëndën time.

Është kërkesë edhe e Komitetit të Arsimit që të shtohet numri i inspektorëve dhe të mbikëqyren pak më mirë shkollat.

Për lëndën e gjuhës shqipe fondi i orëve në çdo javë në shkolla profesionale është dy orë, kurs enë gjimnaze drejtimi shoqëror janë 5 orë. Mirëpo për çudi i njëjti test i servohet edhe nxënësve të Gjimnazit dha të atyre të shkollave profesionale, prandaj kjo është një e metë e ministrisë, sepse nxënësit këtu nuk janë të barabartë.

Testi i maturës del i njëjtë me një rezimë të njëjtë për të gjitha shkollat e mesme, i cili test ka të meta të mëdha në aspektin shkencor, metodik dhe didaktik.

Nuk është kjo reformë, sepse reforma ngërthen në vete shumë faktor didaktiko-metodik, siç janë mjetet didaktike, përtrirja e shkollave me mjete mësimore e cila gjë është thënë nga ish drejtori i Drejtorisë që e kemi bërë një plan zhvillimor për shkollat e Komunës sonë dhe që është përcaktuar dinamika e atij plani, por asnjëherë nuk është realizuar ai plan.

Në shkollat tona përdoret vetëm shkurtesa dhe tabela dhe mësimi zhvillohet në formë tradicionale të vjetër. Nxënësit nuk kanë tekste shkollore dhe marrin njohuri vetëm nga fjala e mësimdhënësit, ndërkaq koha e kërkon që të përdoren metoda të reja.

Ky rezultat i maturës është duke na brengosur të gjithëve, prandaj duhet të angazhohemi me tërë potencialin tonë intelektual duke filluar nga prindërit, nga menaxherët e shkollave dhe Ministria e Arsimit. Menaxherët e arsimit dhe drejtori duhet ta vënë gishtin në kokë dhe të

mendojnë pse është ky rezultat kaq i dobët? Është turp mos të mbërrihet 50% testi i maturës, por do të shihni se në këtë afat do të kalojnë gati të gjithë. Ku është rezultati? A nuk është ky eksperiment? A nuk është kjo lojë me ndjena të prindërve dhe nxënësve?

Uroj që viteve të ardhshme të mos përsëritet këto gjëra negative!

Ish drejtori, por edhe i tashmi vazhdimisht kanë thënë se kemi arrit rezultate në infrastrukturë shkollore, por në shkolla tona ende kemi shkolla ku ora e mësimi zgjat 30 min.

Mos të më kuptojnë dikush që po flasë si opozitë, sepse unë fola për të mirën e të gjithëve.

Tahir Arifi- unë i kam përcjell me vëmendje debatet për testin e maturës edhe në medime dhe gazeta dhe këtu dëgjova me vëmendje dhe unë kam një mendim krejt tjetër për këtë proces. Unë jam shumë i kënaqur me testin e maturës dhe mendoj se rezultati është i fryrë, sepse rezultati real do të mund të ishte diku 35% e dhe në Gjilan, por dhe në nivel të Kosovës. Por ky 35% ne mund t' i japim zjarr sa të duam, por pasqyron nivelin tonë të përgjithshëm kulturor. Gjithsesi qëndrojnë argumentet të cilat mund ta dëmtojnë këtë proces, ora, mësimdhënësi, por ky është niveli ynë i përgjithshëm dhe unë mendoj se në këtë situatë nuk është zgjidhja tek 50%. Nxënësit duhet të hyjnë në test të maturës dhe nuk është më me rëndësi a i kanë 20 pikë, apo 50 pikë, apo 70, kufizimi që 50% e më poshtë ngelin dhe 50% e më tepër kalojnë është gabim! Duhet të harmonizohet me universitetet publike që në bazë të numrit të pikëve që kanë bërë, nxënësit të regjistrohen në fakultetet përkatëse, ku duhet të jetë kriteri më i vogël ose më i lartë.

Kufizimi se nxënësi duhet ta mbërrij patjetër 50%, duhet paramenduar stresin i cili shkaktohet, prandaj na bien nxënësit e mirë! Ndërsa, unë mendoj se kjo duhet të ndodh, nuk guxon të jetë kufiri nxënësi të kalojë 50%, nxënësit duhet të hyjnë në testim, por kjo të harmonizohet me universitetet publike.

Unë mendoj se secili duhet menduar se çka mund të bëjmë më mirë, sepse nuk janë fajtor as arsimtarët as drejtori e Shkollës së Mesme “Arbëria” për atë rezultat, siç nuk është as rezultat i profesorëve të Gjimnazit, pse Gjimnazit ka kaluar me 67%? Kjo është vetëm një pjesë e rezultatit të atyre nxënësve, vetëm një pjesë 25%, 50% janë vet fëmijët 25% janë familjet dhe prindërit dhe 25% në këto rrethana mund të jenë mësimdhënësit.

Unë absolutisht nuk do t' i kisha fajësuar dike tjetër, sepse e di se çfarë nxënës shkojnë në “Arbëri”, por edhe teknikë, në ekonomi dhe mjekësi shkojnë pak më të mirë.

Absolutisht nuk mund ta bëj fajtor dike se ky ose ai mund të ketë faj. Unë e kam kryer shkollën e mesme të bujqësisë dhe kanë qenë kryesisht këta mësimdhënësit të cilët janë sot aty! Nuk duhet ta kërkojmë fajtorin te një grup njerëzish, por secili prej neve ta kryejmë punë nderëshme dhe me një përqindje të vogël të rritë suksesi me 1 ose 2 % për ta parë masën ku jemi saktë. Unë mendoj se jemi diku te 35% dhe prej aty duhet bërë përpjekje për ta rrit suksesin me 1 ose 2% për çdo vit. Fatkeqësisht ky është niveli i ynë kulturor!

Arben Maliqi- është fakt se këtu fajtor nuk mund të bëhet as drejtori duke filluar nga poshtë. Mirëpo po e potencoj dhe pajtohem me Rashitin se testi i maturës është krejtësisht i gabuar dhe ai test nuk na duhet fare! As pak nuk na duhet! Në shtetet e regjionit si në Kroaci nuk ka fare test të maturës. Nxënësi i shkëlqyeshëm 4 vjet dhe ai i shumë mirë nuk ka nevojë t' i nënshtrohet testit të maturës. Mirëpo të jeni të bindur se nxënësit të cilët janë më të dobët, “por janë të gjindshëm” ata kanë kaluar! Shembull është Shkolla Ekonomike, privatistët 70% kanë kaluar! Në shkollën e natës kanë kaluar 70% paramendoni! Këtu varet vetëm prej shkathtësive të nxënësve si din për të vjedhur, kurse për sa ka dije aty është absurde! Mandej është test krejt kontradiktor, dje e tha edhe profesori.

Kjo nuk varet prej neve, por duhet që testi e maturës të mos ekzistojë, sepse është sa për formalitet.

Qemajl Mustafa-desha t' i them pak fjalë, por disi po më vije keq për tonet për të cilat po debatohet për këtë çështje prej dy-tre parafoleëve. Aq ka relativizëm duke filluar nga Tahiri e këndej sa faji nuk i mbetet askujt? Nëse kurrëgjë tjetër së paku ka qenë desh të thuhet sistemi është fajtor! Kjo sigurisht qëndron edhe atë 100%.

Është gjendja kulturore, pajtohem në të cilën gjendje është fëmija i jonë, familja jonë dhe ne në përgjithësi. Ne po flasim për një nivel, nivelin e mesëm dhe aspak më i mirë nuk është në atë nivelin tjetër, është edhe më i keq, sidomos me këtë shkollimin alternativ privat, por edhe në atë publik kemi hiperprodukcion të letrave dhe diplomave, kërkoj falje nga ta të mirët!

Së pari në Kosovë të gjithë nuk kanë studiuar të gjithë kurrë, por dhe nuk do të mund të studiojnë. Ajo që të mos ketë test të kalueshmërisë, por të ketë vetëm njëfarë kalueshmërie dhe fakultet të vendosin për ato çështje edhe ajo funksionon, por në atë rast prejudikohet sikur të gjithë shkojnë në studime dhe mandej edhe atje lihet mundësia sikur këtu që në shkollë të Bujqësisë shkojnë të dobët (kërkoj falje prej nxënësve dhe prindërve).

Është krijuar një modë shumë e keqe dekurajuese dhe e dëmshme për shoqërinë tonë.

Nuk është fajtor drejtori e tha dikush, nuk është arsimtari, mirëpo kush mbetet këtu fajtor?

Ne jemi ata që i pranojmë këta nxënës, ne i bëjmë kriteret për vlerësim, ne japim mësim, ata nxënës e kanë për detyrë për të na dëgjuar kujdesshëm edhe për të marrë dije. Ne i vlerësojmë në mënyrë sistematike në mënyrë të duhur dhe në baza profesionale dhe në fund kur del rezultati që është rezultat jashtëzakonisht varialbil, sepse ju e dini se çfarë rezultati jep gjysmë vjetori i parë dhe çfarë ai i dyti?

Fajtor jemi ne që nuk kemi krijuar qartësi në strategjinë se si do të duhej kësaj çështje t' i qasemi? Unë jam për atë që për këtë të jetë një debat i veçantë të hapet për këtë, sepse këtu doli se vetëm testi nuk ka funksionuar? Unë jam që ta hapim një debat këtu dhe ky Kuvend të dalin me një qëndrim për testin të cilin në nivel kombi e ka përpiluar dikush tjetër. Nëse testi i ka fajet, duhet provuar që ta bindim ministrinë që testin dhe mënyrën e qasje ta ndryshojnë.

Unë nuk mendoj se është kështu, sepse e kemi rastin e Shkollës së Bujqësisë, ajo është fiasko, mua më vjen keq prej dy-tre parafoleëve kur thonë drejtori nuk i ka fajet!

I ka fajet edhe drejtori i Arsimit i ka fajet edhe Qemajl Mustafa kryetari i Komunës i ka fajet sidomos drejtori i shkollës, sepse ai është e ekzekutues aty dhe kujdestarët e klasave.

Të kalojnë 2.70% të kalohet testi, me një moral të vogël publik, unë atë ditë kisha dhënë dorëheqje! Po iu siguroj se po të isha drejtor i asaj shkolle, atë ditë kisha dhënë dorëheqje.

Do të duhej edhe drejtori i Arsimit ta detyrojë për të dhënë dorëheqje, atij dhe kujdestarëve të klasave. Nuk ka më nxënës dhe prind naiv, sepse në teknik kur regjistrohen nxënësit duhet ta dinë matematikën dhe fizikën, duhet prirje për lëndët shoqërore. Ne si shoqëri e bëjmë të kundërtën, sepse në teknik shkojnë të dobët.

Ne kemi raste në arsim ku një mësimdhënës i mban dy vende të punës, por me ligj me sa e di unë arsimtari është i obliguar të jetë 8 orë në proces, ai është vendi i plotë i punës.

Kjo çështje kërkon një debat të gjatë të sinqertë i cili debat do të më ndihmojë mua dhe drejtorit.

Rashit Sahiti- unë desha të them të fjalat e kryetarit i cili tha se arsimtari duhet të rrijë 8 orë në shkollë, por punëtorit arsimor i numërohet edhe përgatitja që i bëhet për orë mësimore.

Por ne sa jemi në nivel të vetëdijesimit sa punojmë për përgatitje të orës mësimore, aty është problemi? Nuk ka infrastrukturë shkollore, ne duhet të bëjmë përgatitje me shkrim. Ish drejtori

i Drejtorisë e ka bërë një fletore për përgatitje, por nëse profesori nuk e bënë një përgatitje prej 5-6 faqe, unë konsideroj se ai nuk është përgatitur për mësim.

Ka profesor që punojnë me zell, ka profesor që punojnë në dy grupe dhe i numërohet norma dhe kësso gjëra ndodhin në shkollat tona.

Arben Malqi- unë e mora fjalën, sepse kryetari nuk ishte këtu kur herën e parë diskutova dhe tash po pyes: Si është e mundur që në Shkollën e Mjekësisë të hapen 10 klasë, për të cilin kuadër nuk ka nevojë aspak? Kemi teknik dhe teknike medicinale plotë, 450 vetë kanë konkurruar për një vend. Nuk ka nevojë! Si është mundur të rritet numri 35, sepse edhe 32 është shumë. Në shkollën teknike ka klasë me 3 nxënës, 5 nxënës dhe 7 nxënës.

Fajin duhet ta marrim të gjithë ne, mirëpo faji qëndron nga lartë! Mos të lejojmë kësso gjëra!

Kush e di sa nxënësi është refuzuar në Gjimnaz dhe në Shkollën Ekonomike? Ka pasur mbi 600 nxënës. Të jeni të bindur se prapë do të rritet numri mbi 35, por nëse nuk rritet numri do të shihet tek Shkolla e Bujqësisë do të ndërrojë gjendja!

Ka shumë nxënës të shkëlqyeshëm që kanë mbetur për pa u regjistruar, por nuk shkojnë në Shkollë të Bujqësisë, unë e kam atë bindje.

Ish drejtori i arsimit e ka sjell nivelin e arsimit aty ku duhet të jetë, dëshirojmë që edhe Bujari të vazhdon ashtu! Respekt për atë për atë që e ka bërë ish drejtori !

Bujar Nevzadi- unë së pari iu falënderoj për këto vërejtje dhe sugjerime. Ne i kemi bërë disa analiza në Drejtorinë e Arsimit edhe në debate publike, por edhe me kryetarin e Komunës.

Mirëpo unë nuk pajtohem me disa vërejte të Rashitit, sepse duhet filluar nga vetja.

Ne në analizën e Drejtorisë kemi thënë para drejtorëve se fajin marrim duke filluar nga unë me ekipin, drejtorët e shkollave e më poshtë.

Absolut ky rezultat që është, unë mendoj që është më real, bile më shumë se e meriton Komuna e Gjilanit ashtu kemi thënë.

Me Tahirin pajtohem ku thotë 35%, në nivel Kosove 42%, në nivel komune ka qenë 48, por dhe ky nuk është real, sepse i kam vizituar dhe parë, si ka qenë. Në disa shkolla është kopjuar, disa nuk kanë ditur as të kopjojnë! Në Shkollën e Bujqësisë absolut janë nxënësit më të dobët të mundshëm në Komunën e Gjilanit.

Unë e përsërit vendimin e kryetarit të Komunës të cilin e ka marrë para disa dite i cili mendoj se do të zbatohet me saktësi dhe deri në fund.

E kemi thënë publikisht dhe po e them edhe këtu se nëpër klasë të shkollave të Komunës së Gjilanit do të ketë 35 nxënës, nuk do të ketë mbi 35 nxënës dhe këtë do ta zbatojmë me përpikëri. Ky vendim ka hyrë në fuqi para se të fillojë regjistrimi i nxënësve.

Tjetër mangësi është se kemi rënie të kriterit të mësimdhënësve i kemi dhënë një vërejtje organizmit nëpër halla dhe objekte sportive i cili ka qenë joadekuat. Po ashtu testi ka qenë jo adekuat. Nuk ka mundësi që testi nga gjuha shqipe të jetë i njëjtë me ato shkolla që i kanë 6 orë në javë me ato që i kanë vetëm dy!

Një vërejtje është se nuk po funksionojnë inspektorët e arsimit, se në Gjilan, Viti, Dardanë janë 7 inspektorë të cilët duhet t' i kontrollojnë 33 shkolla në Gjilan dhe nga 20 Dardana dhe Vitia, do të thotë 70 shkolla me 7 inspektorë.

Mbi gjysmën e arsimtarëve mbi 25 vjet nuk i ka kontrolluar askush! Enti Regjional Pedagogjik nuk ka funksionuar, numri i inspektorëve është i vogël.

Mirëpo gjendja ka ndryshuar dhe sa i përket rendit dhe disiplinës është shumë më ndryshe, në krahasim me të kaluarën. Këtë e dinë të gjithë. Zgjedhja e kuadrit arsimor bëhet sipas kriterëve. Unë tash po gjej se ka arsimtar i cili punon që 10 vjet pa konkurs.

Kam has në persona që janë edukatore, punojnë në mësim klasor dhe janë mbajtur fshehurazi.

Zgjedhja e drejtorëve është bërë ndryshe nga e kaluara .

Ambientit të jashtëm i kemi kushtuar rëndësi, kurse këtë vit janë 18 mijë mungesa më pak krahasuar me vitin e kaluar. Nuk jemi absolut atje ku dëshirojmë dhe ku synojmë, por krahasuar me vitin e kaluar për çdo vit jemi më nga pak më mirë.

Na kanë mbet edhe tri shkolla që punojnë në tri ndërrime, por do të përpiqemi që t' i ngrisim edhe tri shkolla në mënyrë që të gjitha shkollat e Gjilanit të punojnë në dy ndërrime.

Izmi Zeka- pasi që është informatë nuk ka nevojë të aprovohet, mund të kalojmë në pikën tjetër.

14. Informatë rreth punësimeve në SHCK

Izmi Zeka- informata iu është dorëzuar shefave të grupeve parlamentare, nëse ka dikush ndonjë vërejtje mund ta merrni fjalën.

Arben Mehmeti- këtë informatë grupi parlamentar i LDK-së e ka kërkuar, sepse në Administratën Komunale por vërejmë punësime të reja, kurse në anë tjetër ne jemi të informuar se Komuna e Gjilanit ka kufizime në këtë aspekt për shkak të kufizimit të stafit.

Në kohë të fundit kryesisht është punësuar një numër i stafit kryesisht nga koalicioni, kurse një Udhëzim administrativë thotë se punëtorët me kontratë në vepër nuk mund të paguhen prej mallrave dhe shërbimeve. Por ka qenë edhe një informatë tjetër që në Komunën e Gjilanit janë mbi 450, mbi punësime i cili ka qenë një raport zyrtar për të cilin duhet të na jepni një informatë, se për cilët njerëz bëhet fjalë nga ky numër prej 450?

Po ashtu e falënderoj Zyrën e personelit e cila përmes sekretarisë na e ka dërguar një listë të zyrtarëve komunal të angazhuar. Unë në listë po shoh emra të cilët janë duke punuar që disa kohë, kurse këtu evidentohet prej 20.7.2001, kurse sot është data 15. Mandej ka mbi 20 mbi punësime në kuadër të drejtorive përkatëse për të cilët mungojnë përgatitjet profesionale, por mungon edhe pozicioni në të cilin është emëruar.

Zyra personelit është këtu dhe ne kërkojmë që të informohemi më detalisht në të ardhmen për këto gjëra. Ajo që na ka shtyrë për ta kërkuar këtë çështje është se në kuadër të Administratës Komunale ka disharmoni të gradave dhe kualifikimeve. Kemi raste kur një person me përgatitje superiore e ka pagën e njëjtë sikur ai me shkollë të mesme.

Po ashtu kemi raste kur dy zyrtarë janë në të njëjtin pozitë, kurse gradat ndryshohen i cili fakt është jo logjik e cila gjë është rregulluar me Ligjin civil dhe këto raste nuk ka qenë desh të ndodhin. Unë i kam këtu listën e shërbyesve civil të pranuar në vitin 2010. Në këtë listë janë 39 persona të cilëve iu mungon koeficienti dhe nuk dihet ai korrespondon koeficienti me përgatitjen shkollore, te çështja e gradave.

Tjetër tek auditmi grada ku shkruan 15, ndoshta është gabim teknik (ishte sqarimi i Zyrës së personelit) se nuk është gabim teknik, ashtu është me ligj) .

Ka rast ku një punëtor me përgatitje superiore e ka koeficientin 9.5, kurse shefat e sektorëve, 7.5 , prandaj unë po i them disa gjëra që Zyra e personelit nuk duhet lejuar këso disharmoni.

Kemi zyrtar me shkollë të mesme Zoran Simonoviq, zyrtari i lartë i arsimit e ka gradën 8, kurse zyrtarët tjerë e kanë gradën 7. Mandej ka raste që zyrtari me shkollë të mesme e ka koeficientin të njëjtë me atë me fakultet

Në fund po theksoj se këto gjëra Zyra e personelit duhet t' i harmonizojë këto gjëra me ligjet aktuale.

Te lista e QKMF-së, drejtori i kësaj qendre e ka gradën 12, drejtori i QPS-së e ka gradën 6.5 dhe nga kjo shihet se këto janë dallime të dukshme, sikur mos të kishin jetuar në këtë Komunë të njëjtë këta zyrtar.

Po në përgjithësi në QKMF ka disharmoni të mëdha, me të njëjtin kualifikim ka dallime të mëdha në koeficient.

Ne për këtë çështje do ta kërkojmë edhe një raport për të mos pasur diskriminime të tilla në kuadër të SHC.

Qemajl Mustafa- së pari po iu them se është gjendje e gjetur, qysh në janar të vitit 2008. Kam korrigjuar unë në të ecur aq sa kam mundur. Në mënyrë meritore dikujt ia kam ngrit koeficientin, dikujt ia kam zvogëluar. Është një rast se një zyrtar me vite është paguar si dr. Me vite, por është vërejtur se ai nuk është fare doktor i mjekësisë, por për të mos e dërguar në shtëpi e kam zbrit në nivel të koeficientit të shkollës së mesme.

Këshilli i drejtorëve ka punuar që disa javë, organogrami është i përgatitur për të gjitha sektorët, dihen nivelet dhe po bëjmë përpjekje për ta rrit numrin e niveleve, sepse nivelet në nivel lokal nuk përputhen me nivelet në QKMF të cilat i dikton ajo politika e Ministrisë së Shëndetësisë edhe te sektorët të cilët janë kthyer nga Qeveria në Komunë.

Është kthyer QPS dhe Biblioteka dhe aty kemi disharmoni, kurse sa i përket auditorëve, ata janë me ligj të certifikuar dhe sa të thuhet me ligj.

Jemi duke i harmonizuar koeficientet dhe në tri-katër drejtori e kemi përfunduar këtë punë dhe jemi duke vazhduar më tutje dhe këtë organogram diku nga shtatori tetori do ta votojmë.

Po iu njoftoj se 356 zyrtarë i kemi të lejuar, 8 ende nuk janë hyrë në listën e pagave, kurse vetëm tre janë jashtë listës së pagave prej atyre që janë pranuar në mënyrë të rregullt me konkurs dhe 20 të tjerë janë me kontrata të shkurtra një mujore.

Zijadin Maliqi- u fillua të debatohet rreth kësaj informate, por unë nuk po e shoh të arsyeshme që të bisedohet për këtë informatë, kur nuk kemi asgjë para veti. Grupi i ynë nuk kemi asnjë informatë, por po i shoh edhe të tjerët që nuk kanë informatë.

Mos t' i marrin këto gjëra vetëm shifat e grupeve, sepse edhe ne duhet të t' i kemi këto gjëra, nuk jemi këtu argat të baltës, por jemi anëtarë të Kuvendit.

Nëse vazhdoni kështu po ia lëmë vetëm shifave të grupeve pastaj punoni vetëm me shifat.

Ne e kemi deponuar një kërkesë rreth kësaj çështje, por ende nuk është dhënë ndonjë informatë edhe pse është premtuar, prandaj propozoj që për këtë çështje të debatohet në një seancë tjetër, sepse kështu nuk punohet.

15. Informatë rreth vizitave të punëtorëve të SHCK në Shqipëri

Qemajl Mustafa- lidhur me këtë unë nuk kam dëgjuar asgjë deri para pak dite, por në Këshillin e drejtorëve, kemi marrë një qëndrim për t' i stimuluar punëtorët që të gjithë me nga një vizitë në Shqipëri në kohë të ndryshme nga sezona në sezonë.

Kjo vizitë ka vazhduar sipas radhës, por në një debat me qytetarë njëri nga të pranishmit më ka pyetur: “a je i informuar se zyrtarët e juaj kanë vjedhur peshqirë në Shqipëri”

Unë të jem shumë i sinqertë se për te nuk kisha dëgjuar, por kjo më erdhi edhe banale.

Unë e kam filluar njëfarë hulumtim në periudhën kur kanë qenë dhe cili sektorë? Si duket se ka pasur ndonjë problem atje, por unë jam duke i kërkuar emrat për ta ditur se kush janë ata?

Kjo është e pahijshme, por ju distancoheni nga shkrimet banale të ndonjë gazete! Shkrime

banale ku thuhet: “një delegacion” i Komunë së Gjilanit”. Më thoni ju mua kush i ka

deleguar ata njerëz? Çfarë delegacioni është ai? Mandej thuhet nën ombrellën e kryetarit të

Komunës, zotëri Qemajl Mustafës . Një tendencë e ulët e gazetës “ Zëri” e cila po ndodh që disa javë e disa muaj?

Masat do të jenë të duhura ndaj atyre shërbyesve civil kushdo që të jenë?

Sokol Haziri- ngjarja që ka ndodhur në Shqipëri ka qenë një sekret publik, për të cilën ngjarje shkrimin e kam lexuar dje. Mirëpo kjo çka ka ndodhur, nuk është për t’ u nënçmuar ! Unë e di që nuk ka qenë delegacion, e di që nuk ka qenë i deleguar, por e di që kanë qenë gjilanas dhe kanë shkuar në emër të shërbimit civil të Komunës.

Si këshilltarë dhe gjilanas, kërkoj një informacion shtesë. Pse unë si gjilanas ta bartë një barrë të keqe qoftë të SHC dhe kërkoj që ta përgatitni informatën për ngjarjen e cila ka ndodhur atje!

Është bërë një informacion nga Zyra e prokurimit, por ajo është formale, kanë shkuar dhe ardh dhe asgjë tjetër. Unë kërkoj që të përgatitet një informacion i saktë për ngjarjen dhe bartësit e kësaj ngjarje, sepse për këtë veprim i takon kryetarit që të merr masa, sepse vërtetë është rast i rëndë.

Rashit Sahiti- kryetari pat dhënë dosa premtime, njëri është realizuar, por ka premtuar se do të na dërgoj në Shqipëri, por së pari në valixhe tona të na jep edhe nga dy peshqirë se vërtetë ka qenë një turp, prandaj ne duhet t’ i fshijmë djersët këtu

Qemajl Mustafa - me Sarandën me Shën Gjnin janë dy marrëveshje dhe këtë premtim mund ta realizojmë në vjeshtë. Mirëpo ju duhet të përcaktohen a dëshironi të shkoni në Sarandë apo Shën Gjnin? Për binjakëzim e kemi shumë të gatshëm Sarandën dhe Shën Gjnin.

Arben Mehmeti- është një rast i rëndë ajo që ka ndodhur, ne po pajtohemi që të shtyhet për seancën e radhës, por në atë seancë të jenë disa informacione më detale. Ne kërkojmë që të specifikohet nga Drejtoria e Financave secili ka qenë hoteli ku kanë qëndruar zyrtarët? Sa ka qenë çmimi i aranzhimit për persona? Këto shënime i kërkojmë, sepse në ato vizita nuk kanë qenë vetëm shërbyesit civil, por ka pasur edhe njerëz të cilët nuk kanë qenë zyrtarë të Administratës Komunale!

Tahir Arifi- unë me sa di Komuna nuk të drejtë të bëjë marrëveshje kontraktuese me hotele, por Komuna i ka ndjek të gjitha procedurat përmes agjensiosneve të cilat janë të regjistruara këtu në Kosovë. Mandej agjensioni e ka përcaktuar hotelin se ku do të vendosen zyrtarët e komunës sonë.

Me këto debate kjo informatë përfundojë

Rekomandime e Komitetit të Arsimit.

Izmi Zeka- ky komitet i ka tri rekomandime

1. së pari është që komisioni për pranim të kuadrove të plotësohet me një anëtar nga Komiteti i Arsimit
2. është rregullorja për emërtimin e shkollave

Lidhur me rekomandimin e parë si anëtarë për pranim të kuadrove është propozuar Shkëlqim Latifi

Arben Mehmeti- sa i përket rekomandimeve të tjera pajtohem në emër të grupit parlamentar të LDK-së, kurse sa i përket rekomandimit që ka të bëjë me kryesuesin mendoj se është në kundërshtim me ligjin aktual në fuqi i cili e rregullon regrutimin e personelit të arsimit, sepse

në ligjin aktual në fuqi parashihen komisione. Aty duhet dy anëtarë të jenë nga drejtoria përkatëse dhe një drejtori i shkollës, do të thotë tre anëtarë. Nuk kisha desh të politizohet kjo çështje me pranim të njerëzve aty, të zbatohet ligji, sepse ndoshta do të ketë probleme të mëdha në pranim, prandaj është mirë që drejtoria përkatëse ta zbatojë ligjin dhe regrutimi të jetë konformë procedurave ligjore në fuqi.

Me rekomandime të tjera si LDK pajtohem përveç kësaj!

Ejup Haziri- unë edhe më herët e kam thënë, kur një vendim vije si rekomandim prej një komiteti ne nuk kemi pse të humbim kohë, sepse në ato komitete secila parti politike i ka përfaqësuesit e vet. Ndërsa kur u fol për politizim, dihet se Drejtorie e Arsimit udhëhiqet nga PDK-ja, aty nuk mund të ketë politizim.

Saranda Bllaca- këto i kemi debatuar jo vetëm në mbledhjen komitetit të fundit, por edhe më herët dhe ne si komitet kemi marrë qëndrim i cili a do të aprovohet tash apo jo nuk e di? Kemi marrë qëndrim që një anëtar i komitetit të jetë në komision, pa marrë parasysh se kush do të jetë ai!

Në mbledhje kanë qenë prezentë të gjithë përfaqësuesit e partive politike, prandaj si e kam përkrah aty e përkrahi edhe këtu.

Sokol Haziri- unë besoj se shumica e anëtarëve të komiteti janë edhe mësimdhënës dhe të punësuar në arsim, por ndoshta ka të drejtë Arbeni, kur e sqaron që Drejtorja e Arsimit t' i caktojë dy anëtarë por ndoshta është e mundshme që mos të jenë të fokusuar vetëm stafi i Drejtorisë, do të ishte mirë që të konsultohet ligji, sepse ky segment e shpëton pak këtë rast për atë se ndonjë anëtarë mund të jetë i punësuar diku tjetër, prandaj me këtë segment mund të bëhet diçka.

Tahir Arifi- ata që kanë qenë nëpër këto komisione e din që nuk është privilegj për të qenë anëtar i këtij komisioni, sepse unë kam qenë anëtarë dy herë dhe e kam parë se kjo është punë shumë e lodhshme. Mirëpo unë mbështesë këtë qëndrim të komitetit për faktin se cili do që të shkojë në atë komision nga komiteti e ka parasysh se përsëri do të ballafaqohet me Kuvendin dhe jam shumë i bindur se do të jetë më lehtë për neve, pasi që e kemi një njeri nga komiteti në Kuvend.

Izmi Zeka – ju lutem deklarohuni se kush është për ta rekomanduar për komision Shkëlqim Latifin?

Aprovohet rekomandimi i KPF-së që anëtarë i Komisionit për pranim të kuadrove nga Komiteti i Arsimit të jetë Shkëlqim Latifi me 27 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 5 ishin kundër.

Rregullorja për emërtimin e shkollave

Shkëlqim Latifi- kjo rregullore të cilin e ka hartuar komisioni për akte normative dhe të cilën e ka rekomanduar komiteti, mund të them se e njëjta procedurë është sikur për pranim të kuadrit të arsimit. Një rregullore të tillë e ka kërkuar edhe kryetari i Komunës dhe unë mendoj se me Udhëzimin administrativ të cilin e kemi, përveçqë që krijon hapësirë që të formohet një komision nga subjektet politike që mos të politizohet kjo çështje, sepse kjo është shumë e ndjeshme dhe po ashtu krijon hapësirë që të bashkëpunojmë me këshillin e shkollës dhe ne jemi duke u munduar që të gjejmë hapësirë që kjo t' i japë mundësi edhe

shoqatave, organizatave dhe iniciativave të tjera. Po ashtu me këtë rregullore që e ka bërë komisioni për akte normative neni 8.2 . KPF është organ meritator i cili i ia rekomandon Drejtorisë së Arsimit për caktim të emrit të mundshëm shkollave dhe unë mendoj se këtu duhet ta thotë fjalën vetë Kuvendi a do të jetë KPF, apo shefat e grupeve dhe këtu duhet përcjell një opinion të Komitetit të Arsimit, sepse është bërë një lloj anashkalimi, sepse ne e kemi themeluar Komitetin e Arsimit si trup profesionale nga i cili kërkojmë ata të jenë në nivel të detyrës.

Përveç kësaj këtë rregullore e kemi publikuar në ueb faqe të Komunës, po ashtu kryetari i Komunës në konsultim me Këshillin e drejtorëve ka bërë edhe shpalljen publike të interesuarve për emërim të shkollave.

Izmi Zeka- duhet një përmirësim që Drejtoria e Arsimit e përcjell rekomandimin e Kolegjiumit të shefave i cili kolegjium është i përbërë nga të gjitha partitë. Kolegjiumi ia përcjell përveç KPF-së edhe në Kuvendin Komunal
Nuk pati debatues të tjerë kryesuesi e propozon për aprovim

Aprovohet Rregulloja për emërim të shkollave me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

Vendimi për shpallje të interesit në fshatin Shurdhan

Ramiz Jashari- ne keni planifikuar që ta mbështesim këtë, por përmirësoni, sepse në të tri vendimet nuk e keni përcaktuar sipërfaqen !

Izmi Zeka – nëse seancën e ardhshme, sekretaria iu sjell materialin sa për ta parë

Aprovohet ky propozim –vendim me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

Vendimi për lejimi e ndërrimit të pronës për Gjimnazin e ri
Nuk pati debat për këtë pikë të rendit të punës, prandaj kryesuesi e propozon për aprovim/

Aprovohet ky vendim me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit

Vendimi për lejim të ndërrimit të pronës të :”Don Bosko”

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit, ky propozim -vendim

3. Të ndryshme

Riad Rashiti- unë do të paraqes një propozim në pikën të ndryshme të cilin e kam theksuar edhe në seancën e kaluar e cila ka qenë si kontribut për ta plotësuar Kornizën afatmesme zhvillimore. Unë sot këtë kërkesë e kam paraqit me shkrim dhe e lus sekretarinë që me shkrim t’ ia dorëzojë Zyrës ligjore dhe Drejtorisë për Urbanizëm. Kjo kërkesë ka të bëjë për trajtimin e Rregullores për ndërtimet pa leje të cilat janë në hapësirën e Komunës së Gjilanit. Si arsyeshmëri e kësaj është që të krijohet një rregull dhe ndërprerje e ndërtimeve pa

leje, pa asnjë planifikim hapësinor, por si qëllim tjetër është edhe krijimi i të hyrave vetanake në Komunë nga ky zbatim i kësaj rregulloreje e cila pritet që të realizohet.

Gjithashtu në emër të grupit të PDK-së i kemi edhe 7 kërkesa të cilat po i dorëzoj në sekretari për të cilin rast po i referohem secilës drejtori veç e veç.

Të gjitha kërkesat u dorëzuan me shkrim në sekretari.

Izmi Zeka- të gjitha këto kërkesa i kemi parë dhe lexuar, por ne po ia drejtojmë drejtorive përkatëse, sidomos “Higjienës” dhe “Hidromoravës” të cilat duhet ta sjellin një raport në muajin shtator. Gjithashtu edhe drejtorit e tjera duhet ta sjellin nga një informatë në KK.

Ju lutem që të deklaroheni se kush është që të kalojnë këto kërkesa në drejtoritë përkatëse?

Aprovohet kjo kërkesë me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit

Sokol Haziri – unë në fillim të seancës e paraqita një vërejtje së bashku me kolegun nga LDK në lidhje me sjelljet e ashtuquajturës “komisares politike” të Hidromoravës.

Adresimi ishte i qartë, por unë pyes: a qëndron PDK-ja prapa kësaj, apo kryetari, ka qenë mirë të distancoheni prej këtyre veprimeve, sepse për, ndryshe mos kërkon bashkëpunim prej neve !

E dyta është se ne kemi marrë vendim për kompensim të komisioneve të ndryshme, por nuk e di pse nuk implemetohen vendimet e tilla kur i merr ky Kuvend. Drejtorja e Financave nuk e ka të drejtën për t’i komentuar këto vendime, po duhet t’i zbatojë.

Kërkojmë z. Kryesues që pagesa për qira të partive politike të zbatohet dhe të mos ballafaqohemi për çdo muaj me të njëjtin problem!

Izmi Zeka- Drejtorja për Financa ka për obligim t’i zbatojë vendimet e këtij Kuvendi, ajo është aspekt ligjor, por disa çështje vonohen, sepse shumë varet nga buxheti.

Sa i përket asaj se a qëndron PDK prapa atyre kërcënimeve që po thotë z. Sokoli, absolutisht as PDK as institucionet komunale nuk qëndrojnë prapa këtyre gjërave.

Për këtë po ia heqim dilemën se absolutisht nuk i përkrahim, nxisim këto gjëra, por jemi kundër çdo rasti të tillë.

Kjo është shumë e ulët për t’u marrë me gjëra të tilla!

Ne duhet të bisedojmë me këta njerëz, pse ka ndodh kjo!

Ibrahim Neziri- unë desha ta them se ne më parë folëm për kuadro, nëpër shkollat tona, por rasti i fundit ka qenë shumë ekstrem, atëherë kur një nxënës nuk i lejohet për ta dorëzuar dokumentacioni në Shkollën e Mjekësisë. Mirëpo në fund e falënderoj drejtorin e Arsimit i cili e ka zgjidhur këtë rast, kurse sipas drejtorit të Shkollës së Mjekësisë çështja e asaj nxënësve do të ishte mbetur e pazgjidhur. Këtë duhet ta bëjmë me dije për shkak të shtatorit, sepse kjo nuk është hera e parë që po ndodh kështu.

Izmi Zeka- mua më vjen keq për nën kryetarin për komunitete i cili e pat kërkuar fjalën, por të cilit i premtova se do t’ia jap në fund, mirëpo ai ishte i padurueshëm dhe kërkoj falje për këtë rast.

Saranda Bllaca- edhe për neve është një gjendje shumë e padurueshme dhe jo vetëm për nënkryetarin serb. Unë e kam një vërejtje që mos të ndodhin që seancat e tjera t’i kenë nga 18-20 pika të rendit të punës ! Më mirë të ndahen në dy e tri ditë se sa të punohet kështu!

Ne jemi të lodhur dhe ju gjithherë në fund i leni disa pika më të rëndësishme të cilat kalojnë shkel e shko, sikur këto të fundit të cilat kaluan sot, për të cilat nuk patëm mundësi të debatojmë. Unë dy-tri herë e kam kërkuar fjalën për disa pika të mëhershme, por nuk m' u dha rasti.

Nëse vazhdoni kështu seancat tjera mbani vetëm me shefat e grupeve, sepse në këtë mënyrë nuk po e shoh të arsyeshme ne të marrim pjesë këtu!

Izmi Zeka- për këtë problem është mirë ju të merreni vesh me shefat e grupeve, nëpër parti, prandaj sot seanca përfundojë dhe mirupafshim.

Me këto debate seanca përfundoi në ora 16.30

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA